

INTERVISTË ME SHERAFEDIN BERISHËN

Prishtinë | Data: 5 maj, 2022

Kohëzgjatja: 115 minuta

Të pranishëm:

1. Sherafedin Berisha (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Sherafedin, nëse mundeni emrin, mbiemrin, datën e lindjes, vendin, diçka për familjen e juaj.

Sherafedin Berisha: Quhem Sherafedin Berisha, jom i lindur me 9 nëntor, 1954, në Prishtinë në ni familje të varfun me thanë punëtore. Babai im ka punu në lulishte të qytetit edhe na ka majtë pesë anëtarë të familjes me të ardhuna të tina...

Anita Susuri: Ku ka qenë ajo, Lulishtja ku ka qenë në Prishtinë?

Sherafedin Berisha: Lulishtja ka qenë te kjo rruga që shkon në, për me shku te rrethi i Isa Mustafës që po i thojnë aty, qaty, pa shku te ajo te ni pumpë e benzinës, përballë pumpës. Te Ambasada Kroate, afër Ambasadës Kroate aty ka qenë Lulishtja e qytetit. Kanë mbjellë edhe fidane edhe e kanë mirëmbajtë krejt qytetin. Ato që kanë qenë ato pemtë e mbjelluna te Shkolla Ekonomike i kanë mbjellë qajo gjeneratë edhe krejt gati qytetit kto pemtë, i kanë hjekë ni pjesë të madhe të tyne, i ka mbjellë qajo gjeneratë qatëherë mas luftës. Diku vitet e '50-a përafërsisht.

Anita Susuri: Më tregutë për ni histori të familjes qysh kanë ardhë në Prishtinë.

Sherafedin Berisha: Po, i pari i familjes tonë që ka ardhë ka qenë Hajrullah Fetah Berisha. Ai ka ardhë në mes të viteve 1820-1825, nuk e di saktësisht, ka ardhë vetëm me nanën e vet. Arsyeja pse ka mbetë vetëm me nanë nuk e di, se s'kom mujtë me zbulu. Ka ardhë në qytet, ka jetu ktu. Osht' martu kur osht' rritë, ai Hajrullahu osht' martu me ni vajzë të qytetit, ka qenë e ni familjes Toperlaku. Bile kohës, masi osht' rritë gjyshi im i kanë thanë Fejzë Toperlaku, në bazë të, se osht' rritë te dajtë. Ai ka ardhë në moshën katër vjeçare, ai i pari, Hajrullahu, po edhe gjyshi im Fejzullahu ka mbetë pa babë në moshën gjashtë vjeçare. Kështu që, osht' rritë te dajtë.

Ai Hajrullahu ka pasën katër fmi, po, i ka pasë Fetahun, Fehminë, Fejzullahun edhe Fetijen. E fundit ka qenë ni vajzë. Ky, njëni, ky Fetahu ka qenë ka qenë ushtar në ushtrinë turke [Osmane] atëherë që ka qenë nën Perandorinë Turke kjo pjesë. Ka vdekë po nuk e dimë në cilin vend, as babgjyshi nuk e ka ditë kur i ka vdekë vllau. Vllau tjetër i ka vdekë në Prishtinë prej ni sëmundje. Tamon ka ardhë koha e

martësës, osht' feju e krejt, ka vdekë. E babgjyshi ka jetue... edhe ajo halla e babit tim, ajo motra e babgjyshit edhe ajo ka jetu deri në dikund, në '72-ten, 1972 ka vdekë. Ndërsa babgjyshi ka vdekë në vitin 1977.

Babgjyshi i ka pasë edhe ai pesë fëmi, tre djem e dy vajza. Kanë qenë Nazmiu, Ismajli, Fetahu, Xhevrija edhe Fahrija. Prej krejt ktyne vetëm kjo Xhevrija osht' tash në moshën 86 vjeçare osht' gjallë, tjetër kanë vdekë të gjithë. Baba im osht' martu pastaj ka pasë edhe ai pesë fmi. Jom unë ma i madhi, pastaj osht' ni vlla Xheladin, Fehmi, Sheriban edhe Nerxhivan edhe Bastri. I fundit, ma i vogli osht' Bastriu. Të gjithë jem gjallë...

Anita Susuri: Më tregutë edhe ni histori që m'u dokë interesante për, p'i bjen si axhi juj ma i vjetër si me thanë, që ka qenë atje në ushtri edhe që ka ikë prej ushtrisë...

Sherafedin Berisha: Gjyshi im ka qenë.

Anita Susuri: Gjyshi ka qenë?

Sherafedin Berisha: Tetë herë ka qenë ushtarë, e kanë mobilizu tetë herë. Se fmi pa prind, jetim edhe ia kanë veshë, hajt te çojmë dikënd pa dhimtë. Kta zotëritë e qytetit në vend se me e çu djaln e vet e kanë shti në regjistër kto, pa dije të ktina. Ka qenë në shumë shtete arabe, e ka msu edhe gjuhën arabe e pat' ditë shumë mirë edhe turqisht ka ditë. Ai më tregojke se në ni rast, provon me ikë prej ushtrisë turke edhe shëtitet, sorollatet se s'din kah me shkue.

Më tregon ni rast, tha, "Isha i lodhun", tha, "hina me ni shpi, ni ahër edhe rash në grazhd të lopëve edhe flejta. Po", tha, "andërr e pashë që motra më pruni bukë, isha i untë, e u çova e dola t'u qajtë. Rugës t'u shku e kom pa ni gru arabe edhe po më pytë, 'Pse po qan?' Edhe i tregova i thashë se, 'Po qaj se qishtu më ka ndodhë e kom pa andërr motrën time që më ka pru bukë', i nxurrë", tha, "dy peta", se atëherë i kishin majtë mbi kokë ato petë, "edhe dy petë bukë m'i dha".

"I hangra ato", tha, "e munda pak atë urinë. T'u shku rrugës", tha, "p'i shoh do gra e kishin qit' ni fmi të vogël para derës të shpisë edhe po më thojnë, 'A po i knon diçka këtij fmije se nuk po bohet rahat, diçka i kanë ra msysh'", ato bestytini që kanë qenë. Tha, "I knova do dovë", tha, "çka disha. M'i dhanë", thanë, "do pare edhe me qato pare nja dy ditë", tha, "e kalova. Kisha sa me hangër. U shëtita, u shëtita prapë u ktheva në atë kazermën ku isha ushtarë, se nuk disha ku me shkue".

Anita Susuri: S'ka ditë qysh me u gjind.

Sherafedin Berisha: Edhe bash tregojke thojke, “Se na ra edhe ni smundje”, më duket tifusi, tha, “kanë ardhë mjekë anglezë na kanë shërue”. Interesant e knojke ni kangë të Luftës së Çanakalasë¹, në Turqi që osht’. Po e knojke në dy versione edhe shqip edhe serbisht, ksi turqisht, më falni. Thojsha, “Pse?” Thojke, “Po unë e kom msu ushtar atje, e kom mësu turqisht po tani edhe shqip e kom dëgju dhe e kom këndu shqip”.

Anita Susuri: E ka përkthyer ai apo ekziston?

Sherafedin Berisha: Nuk e di, nuk e di. Ekziston se këndohet Kanga Çanakalasë. Edhe isha ktu në gjimnaz, nxanës i gjimnazit, e kem në rrugën kryesore pastaj ni rrugicë është për me shku te shpija. Në krye të rrugës e dëgjoja t’u e këndue. Osht’ interesant se ai ka vdekë me dhomë të vet, kurrë nuk e ka hongër bukën pa e rreshkë, pa e tha mirë. Në oborr kur isha e nijsha kur u mërtypkë, kur kërshitke buka *krrup, krrup* {onomotope} në gojë të tina. Ka qenë shumë i fortë deri në vitin e fundit të jetës.

Anita Susuri: Sa ka jetu?

Sherafedin Berisha: Simbas shënimeve 105 vjet. Po simbas disa ngjarjeve historike që i përshkrujke na dilke dikund 115. Tash cila osht’... po edhe 105... e unë sa isha i vogël i thojsha, se plak e thirrsha, thojsha, “Ti jeto sa të kish qef, unë kom me jetu dy vjet ma shumë se ti” (qeshë). Edhe tash shpesh boj shaka, thom, unë e kom bo kontratën me gjyshin 117 po s’e kom kontratën e vulosun, e kom veç me gjyshin (qeshë). E tani nuk e di.

Anita Susuri: E po më intereson, qysh u kthyer ai?

Sherafedin Berisha: Osht’ kthyer se janë kthyer ato kontigjentet arabe që janë konë edhe u kthyer. Kur u kthyer u shku... edhe u martu pak me vonesë. E ka pasë ni shok edhe ai ka qenë vllau i gjyshës time. Ajo ka qenë shumë ma e re. Bile, shpesh herë bojsha hajgare se nana plakë e thirrsha, thojsha, “Qysh e njeh babën plakë?” Thojke, “Qishtu gjithë me mjekërr”. Se ka qenë pak ma i vjetër, ma i moshun kur u martu edhe i kanë pasë, kanë pasë ma shumë fmi, që i kanë jetu, se nja tre fmi ju kanë vdekë. Njëni ka qenë pak edhe si me të meta, nuk ka ditë as çka osht’ frika, as çka osht’ lëndimi. Shpesh herë e tregojke gjyshja, tha, “Vike”, tha, “e kishin hangër qentë, e kishin kafshu po as nuk kajke”. Po tani i ka rritë pastaj fmitë, babën tim, dy mixhallartë edhe qato dy vajza.

Anita Susuri: E me çka osht’ marrë pastaj...

Sherafedin Berisha: Ka qenë çoban se osht’ rritë fukara, fmi pa babë edhe osht’ rritë, i ka rujtë dhentë e ni zotnie ktu të Prishtinës.

¹ Lufta e Çanakalasë ose beteja e Gallipolit ka ndodhur nga 25 prill 1915 deri më 9 janar 1916 në Turqi. Ishte ndër betejat më të mëdha në Luftën e Parë Botërore. Nga njëra anë luftonin ushtritë Angleze dhe Franceze dhe në anën tjetër luftonte ushtria osmane me ndihmë nga Austro-Hungaria dhe Gjermania. Në këtë betejë fituese ka dalur Perandoria Osmane.

Anita Susuri: E a ju kujtohet naj tregim qysh ka qenë atëherë Prishtina? Ktu rrethi? Kosova krejt në përgjithësi? Po mendoj prej tregimeve të tij.

Sherafedin Berisha: Po, ai më tregojke për disa vende që kanë qenë fushë, për shembull, kjo pjesa kah të shkojsh për Podujevë, kjo Kodra e Trimave që po thojnë, kjo ka qenë fusha krejt. Pastaj kjo rruga që shkon... edhe për, po, ka qenë ni market aty në Kodër të Trimave, s'po më kujtohet, kanë qenë varreza. I kanë hjekë krejt i kanë lshu ato edhe i kanë shitë troje, kanë maru shtëpija aty ma vonë. Kjo pjesa e rrugës që shkon për Kolovicë, nja 300-400 metra përtej Shkollës Teknike ka qenë kodër aty, krejt varreza kanë qenë. Kto kanë qenë varrezat e qytetit. Pastaj, ka pasë, në Prishtinë ka pasë shumë çeshme, që kanë qenë të ndërtume edhe me gypa të dheut kanë qenë, janë furnizu me ujë.

Ka qenë ni çeshme ka qenë i thojshin Çeshmja e Hynilerëve. Ka qenë te Shpija e Pleqve, osht' ni shpi hala e vjetër me ato çapat, çerpiqtë. Bile kur ju kom thonë në Arkiv të Kosovës ni punëtori aty, thashë, "O qy kjo Shpija e Hynilerëve", tha, "Qysh Hynilerëve?" Thashë, "Hynilerë ju kanë thonë atyne", qytetarë të vjetër. E aty ka qenë ni çeshme deri vonë. Pastaj, unë ku e kom shpinë, rruga osht' rruga "Haxhi Zeka", pastaj rruga "Enver Berisha" për me dalë te Medresja e Re, e aty i thojshim Kajnak. Ka qenë ni çeshme edhe aty, uji ka qenë i tharbët. Po kur u mbulu lumi Prishtevka, atëherë osht' zhdukë edhe ajo qeshme.

Anita Susuri: Ujë i gazum ka qenë?

Sherafedin Berisha: Po, po. Po jo shumë si, për shembull, në shishe po i gazum natyralisht kështu. Pastaj ka qenë mulliri aty poshtë, Rruga Llapi që osht' aty. Shpesh herë kur bijke shi shumë, vijke uji prej fshatrave të Gollakut atje, ka ndodhë, ato qysh ka qenë sana e vnume qashtu e ka pru lumi që e ka marrë me veti se ka ra shumë shi. E aty ka qenë ni urë afër xhamisë, shpesh u bllokojke dilke uji pastaj mbi lumë. Çka të thom tjetër? Po, s'di a të pata tregu, më doket këtu mas teatrit ka qenë e mbulume ajo Vellusha, ajo lumi. Se osht' mbulu, pastaj u mbulu krejt deri në Taukbashçe atje. Unë si fmi hisha aty nër, mas teatrit hisha aty në lumë edhe dilsha te, ku osht' Ansambli "Shota" që e ka selinë, te Stadiumi i Prishtinës, atje dilshim. Po nuk ka pasë shumë...

Anita Susuri: Notojshit, a qysh?

Sherafedin Berisha: Jo, nuk ka pasë shumë ujë. Ka pasë përfundi gjunit ka pasë, nuk ka pasë shumë. Po çdo vit t'u u zvogëlu uji. Osht' interesant se ndoshta po kaloj prej teme në temë, ky lumi Prishtevka që ka qenë, ai vijke prej fshatrave të Gollakut. Dajtë i kom ni fshat afër, Makovc osht'. Kur shkojsha te dajtë u dashke me u hyp mbi urë, ni kombësore vetëm ka qenë kështu ni dru se s'mujsha me kalu nëpër lumë se ka qenë uji mbi gju ka qenë. Tash nuk ka asni pikë ujë, osht' zhdukë uji. Këto janë disa gjana që më kujtohet ashtu në mënyrë telegrafike si me thanë.

Anita Susuri: E për babën thatë që ka punu në...

Sherafedin Berisha: Lulishte.

Anita Susuri: Po nana ju j me çka osht' marrë? Ka qenë amvise?

Sherafedin Berisha: Amvise, amvise. Baba e ka kry shkollën ku ka qenë ktu gjimnazi ka qenë shkollë fillore atëherë. Ka qenë nxansi ma i mirë në klasë, jo që më ka thanë ai, po më ka tregu ni drejtor i Bankosit edhe ka qenë ai Izjadin Osmani, mjek i fmive ka qenë, ni klasë kanë qenë. E ai drejtori i bankës më pat' thanë, "Na kemi qenë zero në krahasim me babën tond". Po ata kanë qenë familje të kamura, janë shku e kanë vazhdu medresenë në Shkup. Njëni ka vazhdu... se kanë qenë dy medrese në Shkup. Njëna "Kral Aleksandër", njëna, "Isa Beg".

Anita Susuri: Njo ka qenë ndoshta për muslimanë, njo...

Sherafedin Berisha: Ka qenë e përzime, po ata ka qenë shtetnore ajo, "Kral Aleksandër", e kjo "Isa Beg", ka qenë sigurisht e naj zotnie që i ka pagu harxhimet e kto. E ma s'ka mujtë me shku atje se u dashtë me pagu.

Anita Susuri: Po gjimnazin e ka përfundu...

Sherafedin Berisha: Ktu e ka përfundu, ka qenë nxansi ma i miri, me notat ma të mira.

Anita Susuri: "Sami Frashëri".

Sherafedin Berisha: "Sami Frashëri", po atëherë ka qenë si shkollë fillore, katër vjeçare a qysh ka qenë ajo. E osht' interesant se më tregojke baba kur e kanë mbrojtë atë temën e maturës, tha, "Më thanë ata të komisionit, 'Nëse pranon me u martu me ni sërbe, të shkollojmë". Baba thotë, "Jo". E kap shatin punon në bahçe. E kem pasë tani edhe bahçen që kem produktet i kemi shitë në treg.

Anita Susuri: E për nanën nuk më tregutë prej çfarë familje osht'?

Sherafedin Berisha: Nana osht' familje ktu në fshatin Makovc, Krasniq janë ata me mbiemër. Babën e ka pasë, Martir e ka pasë emrin ai babgjyshi, ka shku tani ma vonë haxhi. I ka pasë edhe katër motra tjera edhe dy vllazën. Nana ka qenë ni njeri i urtë, shumë zemër mirë. Edhe baba ka qenë, baba ka qenë pak i rreptë se ka qenë i drejtë, nuk e ka pranu kurrë padrejtësinë edhe ia ka thanë në sy pa marrë parasysh kush osht' drejt për së drejti i ka thanë. As s'i ka leju, për shembull, me keqpërdorë edhe pse ka qenë shtetnore ajo Lulishtja, kurrë as në xhepa s'ka pasë, ni farë të lulave nuk e ka pasë në xhep. Ka qenë tepër i drejtë.

Bile i thojsha kaniherë, “Tepër. E ke tepër!” Bile ni rast, se i kanë ofrue organizata me marrë ni pllac të, ku osht’ kjo Lagjja Pejton. Pa pagesë me ia dhanë, plus edhe me i dhanë kredi me ndërtu shpijën. E nuk e kish marrë. Thashë, “Pse nuk e ke marrë bab?” Tha, “Nuk e kom marrë se qatynë pronarëve që ju ka konfisku shteti s’ju kanë kompenzu qata. Ata janë shku me lotë në Turqi. I kanë shpërngulë edhe nuk kom dashtë me hi në hak të tyne”. “Po ti s’e ke konfisku ato, ti s’ke qenë shkaktar i konfiskimit”, “Jo”, tha, “nuk kom dashtë”. S’ka marrë.

Anita Susuri: Dashta me ju pytë çfarë zakone ka pasë, për shembull, në shpijën e juj ose nana juj çfarë rregulla keni pasë në shpi? Qysh jeni organizu si familje?

Sherafedin Berisha: Nana ime ka qenë nusja ma e madhe, se kanë qenë familje në bashkësi që kemi jetu familjare. Unë kom qenë fëmiu ma i madh edhe te mixhallartë edhe kështu. Unë i kom ndihmu nanës shumë se u deshke të gjitha puntë edhe me e përgatitë ushqimin për me i çu punëtorëve në arë e në bahçe. E unë i kom ndihmu, ia kom pjekë buktë, ia kom fshi oborrin. Gjithmonë i kom ndihmu nanës, tash i ndihmoj edhe grusë. Kom të drejtë, po thom, se i kom ndihmu edhe nanës (qeshë). Nana ka qenë ni fshatare po pas ni kohe u adaptu edhe në zakone të qytetit. E vetmja gja që kurrë turqishten nuk e ka mësu. Gjyshja e ka ditë e nana nuk e ka ditë. S’e ka mësu kurrë as serbishten as turqishten.

Unë kom pasë fqinjë serbë, nuk e kom mësu serbishten. Në klasën e pestë të shkollës fillore, se i kemi pasë, unë i kom pasë gjashtë landë në gjuhën serbo-kroate. S’ka pasë arsimtarë shqiptarë, ka qenë ajo landa Bazat e Arsimit Teknik, ka pasë me ma hup vitin profesor se ka qenë serb. Po me insistimit e krejt klasës ma dha ni dysh edhe kalova klasën. Gjatë verës, për inati e pata marrë, ka qenë ni gazetë e sportit, “Tempo”, e ka pasë emrin. Në fillim nuk kuptojsha, e kuptojsha vetëm, shut, goll, aut, kurgjo tjetër. Qato i kuptojsha se t’u e përcjellë futbollin. Lexo, lexo ton verën kom lexu. Kur jom shku në vitin tjetër shkollor janë befasu krejt. Profesori thojke, “E ke ditë, s’ke dashtë me folë se e ke ditë gjuhën serbe”. E kom folë tani përfekt. Në bazë të gazetës e kom mësu.

Anita Susuri: E a ju kujtohet, si fmi, qysh u dokë qajo shpija e juj, qajo mahalla?

Sherafedin Berisha: Kanë qenë shtëpia, shumica me, që i thojnë me çatma, me lloq të mbushne ato. Shpija jonë ka qenë, e kemi pasë ni, ka qenë pak në ni nivel ma të lartë po menoj ka qenë edhe nifarë podrumi se oborri ka qenë si teposhtëze e rruga kryesore ka qenë ma naltë. Aty, qaty katin e parë kanë qenë katër dhoma, e kena pasë nifarë hajati që i thojnë, ballkon tash edhe poshtë i kem pasë, që i kemi rujtë kto kafshët. Pjesën tjetër të oborrit e kemi pasë edhe ahrin e deleve, se kemi pasë dele.

Pastaj, kur osht’ bo ndryshimi ktu në qytet ishte kryetar komune ka qenë Nazmi Mustafa, e ka bo, ai ka kontribu ma së shumti në ndërtimin e infrastrukturës së Prishtinës. Kjo rruga “Agim Ramadani”, e kjo “UÇK” janë ndërtu prej tina. Lumi Prishtevka dhe Vellusha janë mbulu prej tina. Ka qenë njeri shumë punëtor. I vetmi kryetar që gjithmonë ka pasë deficit komuna, suficit kurrë se krejt i ka harxhu mjetet.

Ai ka punu shumë për Prishtinën. Kuptohet ka qenë sistemi i atëhershëm, po ai ka mendu për qit' vend. Unë ashtu e analizoj. Eh, se ku dola tash.

Anita Susuri: Te Prishtina, koha si fmi.

Sherafedin Berisha: Po.

Anita Susuri: Mahalla ju për shembull.

Sherafedin Berisha: Ka qenë ni rrugë e shtrume gurë, as ksi kubëza jo, po gurë. Bile, tregojke baba në kohën e ish Jugosllavisë, “Kemi pasë”, tha, “detyrim me dalë çdo njëni para shpisë me fshi rrugën se të kanë dënu nëse nuk e ke fshi”. Fqinj të kanë qenë, shumica kanë qenë shqiptarë, kanë qenë nja dy-tri familje serbe.

Anita Susuri: A ka pasë për shembull ksi fqinjësi me shku te njani-tjetri, me pasë...

Sherafedin Berisha: Te shqiptarë po, po. Jemi njoftë të gjithë, se të ardhun ka pasë shumë pak, po jemi njoftë me të gjithë, kemi pasë shkumje ardhje. Bile, s’di, osht’ interesant ni fakt se qajo rruga “Haxhi Zeka” i thojnë te shpija e Mursel Shumarit, po përpara i kanë thanë Gjymrykhane. Gjymrykhane...

Anita Susuri: Naj han?

Sherafedin Berisha: Urdhno?

Anita Susuri: Naj han?

Sherafedin Berisha: Jo, ka qenë si lloj dogane. Njerëzit kur kanë ardhë prej fshatit u dashtë me pagu doganë për artikuj që i kanë sjellë me i shitë në treg. Ni ka qenë aty ni doganë, ni doganë ka qenë ku osht’ tash Katedralja. Në dy antë të qytetit s’kanë mujtë me hi në qytet me bo shitje. Deri vonë në treg ka qenë, tash s’di a pagujnë, u dashke me pagu që po e shfrytëzon tregun me i shitë produktet e tua. E atëherë për me hi në qytet kanë qenë qito dy pika që janë kontrollue.

Anita Susuri: Domethonë, te Katedralja koka konë si hyrja në qytet?

Sherafedin Berisha: Po, para se me u ndërtu ajo shkolla që ka qenë, “Xhevdet Doda”. Niherë ka qenë stacion i policisë ma vonë aty pastaj osht’ ndërtu gjimnazi.

Anita Susuri: E qysh e kujtoni këtë ndërtimin e Prishtinës? Domethonë, ju veç keni qenë fmi i rritun kur kanë fillu kto.

Sherafedin Berisha: Po, Lakrishtja, për shembull, ka qenë tokë bahçe kanë qenë të qytetit që kanë mbjellë njerëzit të ndryshëm, nuk ka pasë ndërtesa. Ajo ka fillu diku në vitet e '70-a ndoshta, me u ndërtu ato banesat që janë ndërtu. Po janë ndërtu me plan, jo sikur sot që prej ballkonit në ballkon i jep kojshisë kafën. Ka pasë në rregull pak të ndërtimit. Për shembull, soliterat janë ndërtesat e fundit që kanë qenë të Prishtinës pa shku te spitali, s'ka pasë ndërtesa në atë pjesë anej. Pastaj ma vonë janë ndërtu konviktet edhe ka fillu ndërtimi, si me thanë, i egër pastaj. Edhe atëherë janë bo disa lëshime.

Anita Susuri: Qysh e ke përjetu, për shembull, ti personalisht qat' ndryshimin e qytetit? Prej kasabasë me thanë, qytezës së vogël me u bo qytet ma i madh?

Sherafedin Berisha: Po unë jom befasu për disa gjana. Bile, kur u pat' hapë Shtëpia e Mallrave, e reja, m'u ka dokë shumë interesant që ka pasë ato shkallët lëvizëse, ka pasë të ekspozume materiale të ndryshme edhe me kate, ka pasë mobile edhe veshëmbathje edhe ushqim. Në podrum ka qenë ushqimi, kanë qenë në risi. Ndoshta... se pak ma vonë tani kanë ardhë edhe televizorët, bardhë e zi kanë qenë atëherë.

Kur i pajshim do shtete tjera na u doke interesant. Unë edhe kur kom dalë në vitet të '90-a kur kom dalë jashtë, disa gjana na u kanë dokë interesante, se s'i kishim na kto. Çdo veturë, kto firmat, kanë qenë me reklama ose për pastrim ose për ndërtim ktu s'ka pasë atëherë. Ktu ka qenë një Ramiz Sadik, një Eurgens që ka mirëmbajtë banesat dhe s'ka pasë ktu diçka. Pastaj kanë ardhë kësi ndërmarrje ndërtimore si të Pejës e disa tjera, kur e kanë ndërtu këtë pjesën e qytetit poshtë.

Anita Susuri: Në cilën shkollë fillore keni qenë?

Sherafedin Berisha: Shkollën, ka qenë atëherë, tash osht', "Pjetër Bogdani", ka qenë, "Milladin Popoviç", shkolla. Osht' kjo rruga kah të shkojsh përte Shkollës Teknike pak, kthehesh majtas. Aty i kom kry shkollën fillore, pastaj jom regjistru në gjimnaz.

Anita Susuri: A ka pasë edhe shqiptarë aty?

Sherafedin Berisha: Ka pasë edhe serbë edhe shqiptarë.

Anita Susuri: Paralele...

Sherafedin Berisha: Po, ka pasë pastaj edhe romë. Në klasë kom pasë dy vajza rome kanë qenë me mu edhe në djalë.

Anita Susuri: Kanë mësu gjuhë shqipe?

Sherafedin Berisha: Po, ata kanë mësu shqip. E kaniherë u kacafytshim me ata serbtë e bile u përzishin me neve ato. Ka qenë bile njana Xhevrije e ka pasë emrin, nëse s'gabo, e madhe me trup, ajo t'ju hijke (qeshë). Unë kom qenë në klasë ma i vogli me fizikus kështu. Po pastaj në gjimnaz jom rritë ma shpejtë pak.

Anita Susuri: Po më intereson a ka pasë atëherë shëtitje që janë organizu mrena shkollës ose vizita?

Sherafedin Berisha: Po, kemi vizitu ktu, shembull, Taukbashçen pastaj kemi vizitu edhe në teatër kemi shku. Qitu kjo rruga përballë gjimnazit, a din ku osht' Muzeu Etnografik? Afër muzeut ka qenë kopsht zoologjik aty, ka pasë kafshë...

Anita Susuri: Eminxhikëve shpija?

Sherafedin Berisha: Po, Shpija e Eminxhikëve.

Anita Susuri: A keni ide, qysh u konë aty? A keni shku?

Sherafedin Berisha: Po menoj muzeun apo kopshtin zoologjik?

Anita Susuri: Po, kopshtin?

Sherafedin Berisha: Kopshtin, ka pasë disa kafshë, jo shumë. Ka pasë më doket, po, luanë ka pasë, ujk, dhelpën... edhe s'di për kafshë shtëpiake a ka pasë naj njo. Qe s'po më kujtohet se kom fillu m'i harru se ka qenë kohë shumë e vjetër ajo, dikund '65-ten po më duket, s'di sa me thanë.

Anita Susuri: Edhe unë po më duket që kom dëgju ni tregim që ka dalë ni ujk prej aty e ka sulmu dikond?

Sherafedin Berisha: Nuk më kujtohet, jo, këtë rast nuk e di.

Anita Susuri: Po më duket që e kom dëgju.

Sherafedin Berisha: Ka mundësi, ka mundësi. Se s'ka qenë edhe bash i sigurtë aty edhe pse ka pasë disa grila aty po tona janë të mundshme. Baba im ka pasë shumë qef që unë të regjistrohem në shkollë të mjekësisë. Unë thojsha, "Jo se s'muj me pre njerin me bo operacion". "Po, ani", tha, "shko pra për dentist". "Jo, s'ma merr menja me shkue as për dentist". Edhe i dorëzova dokumentat në gjimnaz.

Anita Susuri: Në "Ivo Lola Ribar"

Sherafedin Berisha: “Ivo Lola Ribar”, ka qenë atëherë. Edhe hyna në provim, e kalova provimin edhe po vjen baba prej pune tha, “He”, tha, “çka ke bo? A je pranë?” Thashë, “Jo m’kanë rrxu për pak”. Tha, “Pse po rren?” Tha, “I dyti në listë ishte” (qeshë). Ka qenë dashamir shumë i madh. Sa herë i kom thanë, ka dalë në botime të librave të ndryshëm, romane kto çka kanë qenë, në atë kohë vishin shumë edhe prej Shqipnisë, kurrë s’më ka thanë jo. Paren e fundit ma ka dhanë për me ble libra.

Bile ka qenë në Xha Limani në shkallë të teatrit, aty nalt ai shitke libra. Ma bojke me dorë, “Hajde se kanë ardhë libra të ri” (qeshë). Tash qitu dikund e ka mesa e tij apo vajza, “Xha Limani”, osht’ ni librari qitu. E u pata bo si... ka ndodhë m’i ka dhanë baba paret me ble këpucë, ai më ka dhanë shenjë që kanë ardhë libra të ri, i kom ble librat i kom lonë këpucë.

Anita Susuri: E a ka pasë edhe librari tjera?

Sherafedin Berisha: Po, ka pasë, ka pasë.

Anita Susuri: A i keni vizitu ato?

Sherafedin Berisha: Aty s’ka pasë fort... interesant se Xha Limani ka pasë shumë libra, botime të Tiranës, aty që kanë ardhë për herë të parë. Ka pasë tjera botime tjera po unë s’e di që ka pasë të Tiranës se ka qenë, “Rilindje” edhe s’e di nuk më kujtohen. Ka qenë, ku osht’ tash kjo, Skënderbeu aty ka qenë ni librari edhe kjo kafja që osht’ kjo Unioni, aty ka qenë ni, ni hotel, restaurant. Pastaj ka qenë ni argjentar, ni ka shitë produkte të rrymës, llustera e kto e përballë tyne kanë qenë edhe ato reklamat e filmit edhe qaty afër kanë qenë tani edhe libraritë.

Anita Susuri: E që i përmendët filmat edhe thatë që edhe me shkollë e keni vizitu kto kinemanë...

Sherafedin Berisha: Kinemanë, teatrin, po.

Anita Susuri: Cilat, po menoj atëherë ka qenë Kino Rinia, po më duket?

Sherafedin Berisha: Po, Kino Rinia. E ka pasë emrin serbisht, *Omladina*, i thojshin...

Anita Susuri: Armata e...

Sherafedin Berisha: Armata ku osht’ tash aty...

Anita Susuri: Po edhe tash osht’ qaty.

Sherafedin Berisha: Të njejtin vend, të njejtin vend.

Anita Susuri: Te [sheshi] Zahir Pajaziti.

Sherafedin Berisha: Edhe aty osht' ai... për shembull, ku osht' tash shtëpia e mallrave e vjetra, përmapa, mrapa përmendorës së Zahir Pajazitit, qaty ka qenë bunari i kishës. Ka qenë Kishë Katolike te Grandi. Te, ku osht' teatri ka qenë xhami...

Anita Susuri: E Llokaçit.

Sherafedin Berisha: Xhamia e Llokaçit, po.

Anita Susuri: E deshta me ju pytë, kto, kinematë çfarë filma ka pasë?

Sherafedin Berisha: Ka pasë filma të ndryshëm. Ka pasë filma normal, kuptohet, të sistemit atëherë me partizanë e ato kundër gjermanëve. Ka pasë edhe disa filma të Hollywoodit që kanë qenë me luftanije, shpatat që kanë luftu ato. Ka qenë, "Anijet e gjata", me përkthi "*Dugi brodovi*" i thojshin ata serbisht. Ka pasë filma të ndryshëm. Ka pasë pastaj disa filma indian që shkojshin me kajtë njerëzit aty se të dhimbshëm (qeshë). Ka pasë edhe filma kështu si lloj horrori si me thanë. Kom shku ni film, tri herë e kom përcjellë, tri herë jom frikësu të njejtin vend, kom kcy prej karrigës kështu.

Anita Susuri: Cili film ka qenë, a ju kujtohet?

Sherafedin Berisha: Ka qenë me ni mumje në Egjipt. I mshon murit ai me dorë edhe rrxohet muri edhe bon ni zhurëm ai goxha të madhe. Tri herë të njejtin vend kom kcy prej karrige. Me qëllim kom shku, veç me e pa a po mundem se p'e di që ka me ndodhë qajo skenë. Interesant, instiktivisht kom reague.

Anita Susuri: A keni edhe naj kujtim tjetër qishtu prej ktyne kinemave e kësaj jetës kulturore?

Sherafedin Berisha: S'di çka të them. Teatrin e kemi vizitu shpesh, çdo shfaqje. Bile klasa jonë ka qenë shumë aktive në atë. Edhe në film kur kemi shku, kemi shku të organizum, vetëm klasa jonë, për shembull. Jemi marrë vesh qasi soji që na djemtë me i përcjellë vajzat nëpër shpija. Nuk i kemi lanë kurrë me shku në shpi vet, gjithë i kemi shpërnda. Kush e ka pasë në qat' pjesë... unë i kom pasë katër vajza në qat' pjesën anej.

Njo e kom pasë fqinje aty, më pat' thanë bile baba i asaj vajzës tha, "Me i pasë edhe njiqind vajza me qisi gjenerate i kisha çu [në shkollë] pa kurfarë frike". Jemi kujdesë shumë si m'i pasë të familjes. Nuk ka guxu ajo as me folë me naj djalë tjetër edhe pse ka qenë në moshë atëherë në gjimnaz, që ndoshta ka pasë ndonjë simpati, po pa marrë leje edhe prej neve nuk ka guxu me bisedu me atë.

Anita Susuri: Si motra i keni pasë.

Sherafedin Berisha: Plotësisht.

Anita Susuri: E përmendët edhe ni diçka që kom dëgju për familjet ktu në Prishtinë që kanë jetu, kanë pasë si traditë me shku në piknik nëpër Taukbashçe, Gërmi...

Sherafedin Berisha: Edhe te Tyrbja e Sulltan Muratit për Shëngjergj kanë shku atje. Në Gërmi për 1 maj gjithmonë. Edhe autobusat që kanë qenë atëherë të shtetit nuk kanë guxu me të përdorë atëherë biletë, as taksit me qenë dikush privat privat nuk kanë guxu me pagesë me të çu deri në Gërmi. Atje bojke muzika, ka pasë grupe të ndryshme. U pjekke mishi, flija e kto. Po, ato janë organizue po edhe kha në te Tyrbja e Sulltan Muratit po, për Shëngjergj janë organizue, pikniqe të ndryshme.

Anita Susuri: A u konë, shembull, për Shëngjergj a ka pasë ndonjë traditë të veçantë, a veç si piknik?

Sherafedin Berisha: Po edhe atje për Shëngjergj...

Anita Susuri: U konë diçka, m'u la për do lula

Sherafedin Berisha: E ato kanë qenë në shpi, nuk janë bo atje. Para mëngjesit i kanë la, i kanë qit' në atë kazanin e ujit kanë qit' lula, kanë qit' hitha edhe shelgje. Kanë thanë, "Ato që te nxen mëngjesi i hershëm në gjumë, ka me i shku krejt viti në gjumë", qashtu ka qenë nifarë bestytanie. Ka pasë kto gjana, por dalëngadalë ato janë zhdukë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Po, njikohësisht edhe ju thatë, domethonë, gjeneratë jeni e '54...

Sherafedin Berisha: '54-sh.

Anita Susuri: Edhe ju veç keni qenë '64-tën - '65-tën kështu fmi, njëmbëdhjet vjeçar. U konë ni periudhë e vështirë për popullin se u konë koha e Rankoviçit...

Sherafedin Berisha: Koha e Rankoviçit, e armëve.

Anita Susuri: A ju kujtohet diçka që keni pa, familjet që janë largu?

Sherafedin Berisha: Drejt për së drejti jo, se s'kom... në rrethinë aty ku kom jetu unë nuk ka pasë. Ma së shumti ka ndodhë në disa fshatra në rrethinë e Pejës, ka ndodhë edhe në Llap ndoshta ka pasë,

nuk po jom i sigurt po ktu në qytet nuk osht' vërejt fort ajo. Kështu që, nuk di çka të them. E di vetëm kur janë bo demonstratat e '68-ës, unë nuk kom qëllu në shpi, kom qëllu te dajhtë. Kur jom ardhë të nesërmen në shpi kom dalë në qytet e kom pa qytetin që osht' shkatërru me ato vitrinat e dyqaneve e ato. Ajo më kujtohet.

Anita Susuri: Thatë që gjimnazin e keni vazhdu ktu në "Sami Frashër" që është tash...

Sherafedin Berisha: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë qato vite për juve?

Sherafedin Berisha: Ajo ka qenë gjenerata e arsimtarëve ka qenë gjenerata ma e mira, e kanë dashtë arsimin me shpirt, na kanë msu. Ka qenë gjeneratë shumë e mirë edhe shumica e atyne arsimtarëve kanë kalu ose nëpër fakultet ose në institute të ndryshme. Në Institut Albanologjik e të Historisë. Ka qenë gjeneratë shumë e aftë e profesorëve. Disa janë hala aktivë, për shembull, Jahja Koka, ai m'ka dhanë fizikë. Bile m'kujtohet ni rast, ka qenë ni shok i klasës, ai në klasë e ka ditë fizikën ma mirë se të gjithë na tjetër edhe boni pak ni, e ngriti pak zanin. Ai po i thotë, tha, "Jakup", tha, "shife", tha, "me i pasë 75 kilogram", tha, "me ni dorë të qes prej dritare jashtë". Tha, "Sa kilogram i ki?" Tha, "75 e gjysë. Për gjysë kilogrami s'munësh me më qit". Filloi edhe ai vet me qeshë se e zuni keq (qeshë). Unë kom qenë në matematikë pak ma mirë me ni shok, ni Agron Manxhuka ka qenë.

Ka qenë ni libër goxha i trashë voluminoz i ni profesori kroat, titullin e ka pasë, serbo-kroatisht atëherë janë konë shumica e literaturës, "*Zbirka zadataka iz algebre*/ Zgjedhja e detyrave të algjebërës". Me qat' shokun gjatë pushimeve verore i kena zgjedhë të gjitha detyrat. Pos, vetëm ni detyrë nuk mujshim me zgjedhë. Provo, provo, nuk na dilke rezultati. Edhe po i thom, "Agron, a shkojmë prej fundit?" Tha, "Pse?" Thashë, "Dikund osht' ni gabim". T'u i shku prej fundit me dalë në fillim e gjetëm gabimin ku osht', ish bo gabim, i shtypjes sigurisht, ni numër e kishin shtu tjetër. Në vend, për shembull, të katërshit e kishin shënu dysh edhe nuk dilke zgjedhja.

Kur erdhëm në shkollë, po thotë profesori, tha, "Çka keni punu?" Po na pytë kështu. Thashë, "Profesor i kena zgjedhë krejt detyrat me Agronin, po ni detyrë s'kemi mujtë me zgjedhë". Tha, "Cilën?" Thashë, "Qita". Tha, "Kjo osht' ma e lehta". Filloi me zgjedhë, nuk i dilke, s'dilke. Dy orë se i kem pasë dy orë ngjitur të matematikës as pushimin nuk na la me dalë jashtë. U mundu, u mundu, u mundu. Tha, "Jo", tha, "s'paska zgjidhje", thashë, "Ka", "E pse po më malltreton?" Thashë, "Ndrro qit' numër", e ndrroi. Tha, "Qe dy orë na hupe qitu", thashë, "Unë i kena hupë me Agronin ni javë ditë edhe e kemi gjetë t'u i shku prej fundit" (qeshë). "Ku ju ka shku menja", tha, "prej fundit me zgjedhë?"

Kemi qenë ni gjeneratë shumë e mirë. Shumica prej tyne janë tash ka edhe mjekë edhe ka drejtorë. Në postë ka qenë ni Hazbi Dervisholli, ka. Unë e lash pak mrapa fillova me studiu ekonomikun pastaj u

kyça në ilegale edhe u ndrru pak rrjedha. Edhe pse s'osht' fajtor ilegalja që e kom... po unë e neglizhova pak, u burgosa pastaj, u martova edhe më shkeli rrota. E mbet fakulteti pa e përfundu.

Anita Susuri: E qysh vendosët me shku në ekonomi, masi përfundut maturën?

Sherafedin Berisha: Po shkun disa shokë të klasës edhe m'u doke ma interesant edhe masi ish matematika pak ma e kërkume aty shkova në ekonomi. Se ni pjesë kanë shku në juridik, ka shku dikush dikush në mjekësi.

Anita Susuri: Po harrova, e tejkalova këtë pyetje, a keni pasë mramje të maturës?

Sherafedin Berisha: Po.

Anita Susuri: Ku ka qenë?

Sherafedin Berisha: Në Hotelin Bozhur atëherë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë?

Sherafedin Berisha: Shumë e mirë ka qenë. Për herë të parë që kom veshë kompletet të... edhe ato m'i ka qepë rrobaqepësja se s'i kom ble të gatshme. Baba, po të thom, për arsim ka qenë në gjendje çdo gja me ba.

Anita Susuri: A kanë kepë zakonisht, a kanë ble qysh ka qenë?

Sherafedin Berisha: Ka pasë edhe me ble, po ai baba tha, "Jo, po du me t'i qepë". Edhe në qat' kohë u pat' kthy ni rrobaqepës, ka qenë në Francë ka punu disa vite edhe erdh. Ka qenë ndër ma të njoftunit. Te ai m'ka çu me i qepë rrobat. Kemi qenë klasë shumë kompakte, shumë e mirë. Tani kemi bo hajgare aty edhe me profesora, iu knojshim profesorave, iu qitshim kangë. Edhe për mramje të maturës iu knojshim edhe ktu në gjimnaz.

Bile, ka qenë ni profesor i gjuhës shqipe edhe tani i ngacmojsha unë do profesora tjerë, thashë, "A e dini ku", se Buf i thojshim atina, s'po ia përmendi emrin atij profesori, thojshim, "a e din, qysh e dijnë që po vjen Bufi në klasë?" Po më thotë, "Qysh?" "Se ma përpara i hin barku, tani hin ai", se ka qenë shumë i plotë (qeshë). Eh, ka qenë ai profesori i gjeografisë, Rifat Blakaj. Ai e ka pasë ni zakon, kur hike në klasë thojke, "Kadale dil leblebixhi!" Qishtu na u drejtojke. Kemi qenë si shokë, jo si në atë kuptimin profesor nxanës, po kemi pasë ni afërsi shumë të madhe.

Anita Susuri: E në këto mramjet të maturës, po edhe kështu zakonisht, çfarë muzike u lëshu? Çfarë muzike keni dëgju?

Sherafedin Berisha: Po, ma së shumti muzikë popullore. Ka pasë edhe muzikë zbavitëse, ka qenë atëherë Trixs më duket ka qenë. Po unë ma shumë kom qenë i orientum te kjo muzika popullore dhe folkloristike. S’di aty e kom, edhe tash e kom pikë të dobët edhe pse edhe kto i kom dëgju. Pastaj kemi organizu edhe udhëtime mas mramjes së maturës. Kemi shku në vizitë nëpër Jugosllavi, kemi qenë në Kroaci, në Slloveni, Postojna e kemi vizitu.

Kur kemi shku, osht’ interesant ni detal se kemi qenë katër autobusa me nxanësa shqiptarë, ni ka qenë serbë edhe turq më duket, po serbë edhe turq se nuk u mushën ma shumë. Kur kemi shku në Zarë kemi zbritë prej autobusit na shqiptartë të gjithë, serbët asnjë nuk kanë zbritë. E kem taku ni plak, na dëgjoi t’u folë shqip, “Hë”, tha, “shqiptarë jeni?” Tham, “Po”. Filloi me folë ai, arbëresh i Zarës. Edhe po i thotë plaka e tina, ishte shumë, atë ditë ishte e diell nëse s’gabo, ishte t’u shku në meshë, tha, “Hajde, a do të vishë në meshë?” Tha, “Jo”, tha, “do të ndalem me kta çunat edhe këto vajzat”. Tha, “Pse?” Tha, “Qenkan gjaku ynë”.

Kemi bisedu me atë plakun, jemi knaqë muhabet. Tani po më tregon, tha, i ka disa studenta të Zarës që janë arbëresh e studiojnë në Zagreb edhe kanë kontakte me studenta shqiptarë, “E dijnë”, tha, “gjuhën edhe ma mirë se na, se e dijnë gjuhën letrare”. E kemi taku edhe prej atyne studentave. Po më kanë lanë shumë përshtypje. Po qajo më ka mbetë e fiksume që vetëm shqiptartë zbritën prej autobusit, tjetër jo (qeshë).

Anita Susuri: E do të thotë që veç domethonë vitin e parë ndoshta në fakultet keni fillu në llogaritë?

Sherafedin Berisha: Po, qaty ka qenë.

Anita Susuri: Po më intereson tash krejt kjo qysh ka ndodhë? Fillimi? Qysh keni marrë vesh? Qysh jeni inkuadru?

Sherafedin Berisha: Jom inkuadru nëpërmes një fqinjit tim aty, osht’ ni Mustafë Ademi. Kemi pasë edhe ni lidhje familjare pak me ta. Ni teze imja ka qenë për vlla të tina e martume. Për herë të parë më të i kom pasë kontaktet. Pastaj, në shpi tina ka banu edhe Gani Sylja me dy motrat. Kanë qenë nxanës, pastaj edhe studenta. Nëpërmes Mustafës janë njoftu pastaj me Ganinë edhe qaty ka fillu ajo rrjedhja e llogaritë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë qajo, domethonë, rregullat ndoshta për me hy?

Sherafedin Berisha: Po, rregullat i ka caktu ai që ka dashtë me pranë dikond. E ka studiu njerin a bon të futet, të ketë besim, edhe ai e ka konsideru që bon. Dhe kemi fillu njëherë me ni lexim të ni librit edhe të ni librit edhe pastaj me biseda edhe deri te kyçja edhe dhanja e betimit. Në, unë kom qenë i kyçun në ni treshe me Ganiun edhe ni tjetër, po ma vonë tani Ganiu pat’ shku ushtar. Ai ka qenë i

lidhun edhe me kryesinë e grupit, Grupit Marksist-Leninist të Kosovës. Atëherë, unë e kom zëvendësu atë mirë boll.

Edhe kemi qenë në kryesi të grupit, kemi qenë unë, Mehmet Hajrizi, [Hydajet Hyseni](#), Kadri Zeka edhe... po ky në qat' kohë ishte Ganiu ushtar, na kemi qenë qatëherë në kryesi të grupit. I kemi pasë të caktum me sektorë të ndryshëm të punëve. Për shembull, dikush ka qenë për agjitacion edhe propagandë, dikush për tjera gjana edhe kështu që kemi pasë sektorë të ndryshëm të ndarë të punës tonë. Kemi mbajtur mbledhje niherë në javtë, në dy javtë, por ma shumë se dy javë nuk ka shku asniherë.

Anita Susuri: E ku i keni majtë këto mbledhje?

Sherafedin Berisha: Nëpër shpija ose ka pasë edhe raste kur ka qenë koha e mirë edhe në natyrë i kemi majtë. Kemi pasë edhe disa baza ku i kemi mshefë materialet.

Anita Susuri: Këto librat që thatë që i keni lexu, a kanë qenë libra, sigurisht ilegale?

Sherafedin Berisha: Shumica kanë qenë ilegale.

Anita Susuri: Cilat libra kanë qenë, për shembull?

Sherafedin Berisha: Po, ka qenë ajo, "Shota Azem Galica", ka qenë ilegale atëherë edhe pse s'ka pasë diçka kështu drejt për së drejti, po nuk është pranë. "Gjarpërinjtë e Gjakut", ka qenë i ndalim për shkak të autorit ndoshta, se jo për shkak të përmbajtjes që ka pasë diçka kundër shtetit të atëhershëm. Edhe shumë libra tjerë. Tani kemi pasë edhe fotografi që vetëm i kemi pa qytetet e Shqipërisë, monumentet historike, muzetë e ndryshëm. Pastaj, kemi shkru edhe shkrime të ndryshme që janë shpërnda nëpër shtypin ilegal. Kështu.

Anita Susuri: Domethonë, ata ju kanë parapërgatitë juve njëherë...

Sherafedin Berisha: Sigurisht.

Anita Susuri: Ju kanë dhonë me lexu materiale...

Sherafedin Berisha: Po, sigurisht, sigurisht.

Anita Susuri: Me ua zhvillu ndoshta ma shumë atë ndjenjë...

Sherafedin Berisha: Po edhe zakonisht janë zgjedhë pak edhe familjet të cilat osht' ditë pak që janë ma të lidhura me çështjen kombëtare.

Anita Susuri: E cilat kanë qenë aktivitetet tjera? Thatë që keni pasë materiale që keni shpërnda.

Sherafedin Berisha: Po janë shpërnda trakte të ndryshme në raste të ndryshme. Për shembull, kur ka qenë ai përvjetori i Lidhjes së Prizrenit janë shpërnda materiale. Gjatë vizitës kur ka ardhë Tito në Kosovë janë shpërnda materiale kundër sistemit. Kështu, të ndryshme.

Anita Susuri: Çfarë përmbajtje, shembull kanë pasë kto materiale?

Sherafedin Berisha: Në ato, ma shumë ka pasë, ka qenë i theksur ajo ngritja e ndërdijes kombëtare te popullata. Kemi mundu me hy në popull, po nuk kemi guxu me shku haptas po në disa raste pak kemi vepru varet edhe vendi ku edhe haptas kemi folë kah pak. Po ma shumë me trakte, me libra t'u i shpërnda nëpër rini ose edhe te arsimtarët.

Anita Susuri: A ka pasë kto trakte, për shembull, diçka edhe për historinë tonë? Ose diçka për, si me thanë, pozitën tonë ktu në Jugosllavi?

Sherafedin Berisha: Po, ka pasë, ka pasë. Për shembull, ka qenë ni punim e pata shkru atëherë ka qenë, "Politika e dyerve të hapura, politikë e kapitulimit ndaj kapitalizmit, nënshkrimit". Se si ka qenë atëherë Jugosllavia, për shembull, që ka pasë marrëdhëniet ma të mira edhe me Perëndimin edhe me Lindjen, se ka qenë në dy karriga e ulun. Pastaj, kuptohet ka pasë edhe vjerrsha të ndryshme, pak osht' lartësu edhe figura edhe Enver Hoxhës atëherë. Bile, shpesh herë njerëzit thojnë, "Po ku Enver Hoxhën?" "Po", thojsha, "unë e kom dashtë. Ma mirë me thanë shoku Enver, se me thanë *Druže* [Shoku] Tito", se ma i afër m'u ka dokë.

Në atë kohë me pasë thanë, për shembull, qysh po paraqiten tash disa që janë demokrat të fortë shumë, me pasë folë atëherë me lavdu Amerikën ke pasë dënim edhe ma të madh, se sistemi i Jugosllavisë ka qenë komunist. Po edhe Shqipëria ka qenë qaty, po ka qenë ni tjetër shkallë. Se Jugosllavia pastaj i ka evitu disa gjana ka kalu në revizionizëm. Edhe na s'kemi mujtë me thanë atëherë e dojmë Amerikën se kemi qenë të dënumë edhe ma shumë (qeshë).

Anita Susuri: Po se ka qenë në atë periudhë edhe Lufta e Ftoftë.

Sherafedin Berisha: Po, ka qenë edhe Lufta e Ftoftë.

Anita Susuri: Po, ka qenë Amerika kundër shtetit... Ruisë.

Sherafedin Berisha: Edhe pse ajo vazhdon edhe tash.

Anita Susuri: Po.

Sherafedin Berisha: Edhe pse komunizmi thuajse osht' gjunjëzue po nuk osht' shue, se osht' gjallë hala.

Anita Susuri: Dashta me ju pytë edhe për familjen, a ka ditë dikush prej familjes të juj që keni qenë në këtë rrugëtim?

Sherafedin Berisha: Në fillim nuk ka ditë kërkush, se ndërkohë tani unë edhe u pata martue, as gruja s'e ka ditë. Ka ndodhë kom shku në takim gjithë natën, s'e ka ditë gruja ku jom. Kuptohet se ajo si vajzë e re, 18 vjeçare, s'ka pasë as të plota 18 kur jemi martu. Ka dyshu nashta që a kom naj dashnore apo diçka tjetër (qeshë) edhe pse sjellja ime i ka dhanë me kuptu edhe asaj edhe tjerëve që nuk jom i atij, asaj kategorie. Bile ni shok i jemi, ai Gani Sylja, thojke, "O Shera, ty me të pa rrugës, policia e din që je ilegal". "Pse?" Thojsha. Tha, "Po shkon si gërmustë pak edhe s'po kqyrë anash, s'po bon zhurmë shumë", thojke, "mos, ndrro pak lëvizjen".

Kështu që, në familje nuk e kanë ditë deri vonë. Ma vonë e ka kuptu nana edhe baba edhe ni motër e imja. Po s'e kom pasë problem. Ma vonë, shumë ma vonë u dekonspirova edhe te disa njerëz që kishin hyrje-dalje me familjen tonë. Ju thashë shokëve, "Unë po largohem diku", se isha, ish problemi se nuk dojshta me dëmtu grupin për shkak të ni gabimit tim që u dekonspirova.

Anita Susuri: Kjo dekonspirimi, qysh ka ndodhë? Keni folë ndoshta dikund diçka ose?

Sherafedin Berisha: Jo, m'u zbulu ni shaptilograf edhe e morën vesh disa njerëz që s'u deshtën me ditë. Atëherë qesh i detyrum me shkatërru shaptilografin. Veç e kom pa si hekër, kom dashtë me marrë me shitë. Edhe e kom shkatërru shaptilografin, e kom demolu krejt edhe i kom hudhë, që me mujtë me mbulu gjurmë pak, po nuk besojsha prapë që e kom arritë qëllimin.

Anita Susuri: E qysh jeni largu pastaj? Jeni largu prej shpijave?

Sherafedin Berisha: Jom pasivizu...

Anita Susuri: A veç jeni pasivizu?

Sherafedin Berisha: Jom pasivizu. Tani shkova edhe ushtar në vite të '80-a...

Anita Susuri: Në vitin, po më duket '81?

Sherafedin Berisha: '80-të, në '81-shi...

Anita Susuri: Po se ni vjet keni pasë ushtri.

Sherafedin Berisha: Unë i kom pasë ni vjet se isha si mbajtës i familjes, i martum kisha ni vjet se ka qenë 15 muj. Në marina ka qenë më duket 18 muj nëse s'gabo, ma i gjatë ka qenë pak kush ka qenë në...

Anita Susuri: Ku keni qenë?

Sherafedin Berisha: Kom qenë në Kroaci, në ni vend Knin. Ai osht' si me thanë, osht' çerdhja e çetnikëve të Kroacisë se ka shumë serbë aty. Bile, kemi pasë ni gjeneral ka qenë komandant i kasarnës, i lshova mustaqet pak si të gjata kështu e po më thotë, tha, "Shko hiqi mustaqet", tha, "se po m'dokesh si kundër atyne që kom luftu në Luftën e Dytë". Ai kish qenë partizan, po fmi më duket 17 vjeç kur kish luftu në Luftën e Dytë. Na thojke, "Në qit' kafene, në qit' kafene", na caktojke me emër, "nuk bon me shku me hy se ata janë çetnikë".

Anita Susuri: Ai ka qenë kroat a?

Sherafedin Berisha: Kroat. E e kom, se në fillim unë kom qenë gati gjeneratë ma e vjetër se shumica e atyne shokëve që ishin aty ushtarë. Po vjen ni kroat i Bosnjes tha, "A po vjen", tha, "me punu me ni grup punues", tha, "u knaqëm. Po punojmë pak pak edhe as s'po kemi ushtrime ushtarake, as obligime të ndryshme. Po shkojmë veç me këpucë, shumë shlrë". Edhe u lajmërova unë aty si murator aty kishe, s'disha, lidhje s'kisha. Aty për herë të parë kom msu ai djali me ujë mësojke qysh me hudh mallterin për me ly muret, me suvatu.

Ka pasë ni afërsi pak ma të madhe ai me atë grupin punues. Ai oficeri, ish komandant i kasarnës thojke, "Ju vleni ma shumë se krejt ushtartë knej", se e patëm ndërtu ni qytet mrena kazermës, qytet për me simul luftën në qytet si bohet. Me hekurudhë, me rrugë, me ndërtesa, krejt i patëm bo. Na dojke ma shumë se, se rregull në ushtri ka qenë që roja, ata që bojnë roje shkojnë të partë me hongër ushqim në kuzhinë, na shkojshim para tyne. Thojke, "Kta janë të partë, pastaj vijnë tjetër". E për atë arsye ai ka pasë disa të drejta. E qaty kur më ka pa qashtu tha, "Shko hiqi", tha, "se po m'duket si ata që kom luftu kundër tyne", (qeshë). Çetnikët. S'di çka m'u dha se kurrë s'kom pasë qef as mustaqe, as mjekërr me lshue, as flokë të gjata jo.

Anita Susuri: E tani ju ka ra po më duket pak, në '81-tën, në fund të '81-tës m'u kthy, a qysh?

Sherafedin Berisha: Jo, pas demonstratave nja ni muj jom kthye. Unë isha ktu i mora ato uniformën civile, si me thanë kështu, për, se i kisha edhe tri javë më duket m'u lshu prej ushtrieje. Unë u ktheva për Kroaci, ktu pëlcitën demonstratat. Më pati marrë në pyetje ni major i sigurimit shtetnor të ushtrisë edhe m'i bojke do pyetje si provokative. Thashë, "Jo bre", thashë, "ka qenë kjo naj revoltë e studentave se populli s'ju ka bashkangjtitë atyne demonstratave". "Fatmirësisht", tha, "që s'ju ka bashkangjtitë populli", a populli ju kish bashkangjtitë me shumicë (qeshë). A unë i kisha informatat se folsha në telefon. Po, ai ma priti ata tha, "Jo", tha, "fatmirësisht s'ju ka bashkangjtitë", tha, "populli se ish bo mos vet".

Anita Susuri: E qysh u pritë tani qajo demonstratë në rrethin e kuj?

Sherafedin Berisha: Ku, ushtar a?

Anita Susuri: Në ushtri.

Sherafedin Berisha: Faktikisht nuk kemi pasë fort komunikime sa i përket asajna, se nuk ke ditë me kënd po bisedon. Ka qenë disa, kanë qenë me ni rast dy djem të ri, më vike keq prej tyne se rrishin fort me ushtartë serbë edhe i msojshin me përdorë fjalë të ndyta, “Jo shani, jo kto...” Thojsha, “Mos i msoni se keni me pasë problem”, i msunë. Fillunë me i sha tani u nxunën u rrehën edhe i dënunë, për shembull kah ni javë ditë paraburgim aty i majshin. Thashë, “Nuk bon me hy ashtu, rri, maje distancën ma mirë”. Se e kom pasë si princip nuk e kom sha kurrë kërkënd, po edhe nuk e kom duru kërkond me më sha.

Edhe në punë kur kom qenë, niherë ni serb e përdori ni fjalë të keqe, më shajti ia kom ngjitë për gryke. Se kom punu në burg, në shank kom punu në fillim, kom zi kafe. Ia kom ngjitë për gjoksi i thashë, “Ta hjeke krytë”, se e kisha thikën t’u i pre do limona. “Jo”, tha, “se s’e pata po me kta tjetër”. “Ti shaju me kta çka të dush, me mu jo”. Kur e kom ndrru vendin e punës kom kalu pastaj në [Hotel] Grand ma kanë dhanë dorën shumica e punëtorëve. “Bravo të qoftë, kurrë s’e ke sha kërkond, kurrë s’e ke duru kërkond me të sha”. Thashë, “Unë nëse të shaj niherë, ti dhetë herë shajëm nuk është problem”.

Anita Susuri: Në Bozhur e në Grand a keni punu mas burgut?

Sherafedin Berisha: Në Bozhur kom punue para burgut, aty tani kom kalu si depoist. I kom pasë menzat shoqnore, në Fabrikë të Tapetave ka qenë ajo e mobileve, “Napredaku”, edhe fabrika e, kjo, “Kosovatransi”, që i ka pasë ato servisin e autobusave. Tash ku osht’ qaty përballë shkollës ekonomike. Qato i kom furnizue, qato objekte edhe i kom majtë evidencën. Edhe ni kafene ka qenë në qosh ku shkojsh te Fabrika e Tapetave aty, qato i kom... prej aty jom burgosë.

Në të vërtetë kom kalu në Grand si depoist kryesor i krejt organizatës. Se hoteleria kjo e Prishtinës, “Sloga”, që e ka pasë emrin ka qenë e ndame në katër reparte. Unë kom qenë depoist i ni reparti Fushë Kosovë, me mensa të studentëve, mensa të punëtorëve, me ka qenë ajo Tre Sheshirat ni kafe edhe ni Restaurant Beogradi. E ato i kom furnizu unë si depoist kryesor. Kom shku ushtarë, kur jom kthy prej ushtrisë kom punu edhe nja katër muj, a pesë, pesë muj edhe jom burgosë tani.

Masi kom dalë prej burgut kom bo kërkesë me më kthy në punë, shumica kanë qenë për me më pranu, po ni serb, “Qysh p’e merrni atë? Ai armik i popullit, qysh p’e merrni në punë?” Edhe nuk kanë guxu asni shqiptarë pastaj me ngritë dorën me më pranu edhe s’më kanë pranu. Mas lufte kom punu prapë në Grand derisa u privatizu e na pritën (qeshë).

Anita Susuri: Qatëherë para burgut, qysh u konë me punu në [Hotel] Bozhur e në Grand? Se jonë konë si ma të famshme vende për me dalë në Prishtinë.

Sherafedin Berisha: Po, ka qenë nifare kënaqësie se ka pasë shumë punëtorë shqiptarë. Në fillim se axha im ka punu drejtor në Bozhur. Ai kur u kthy mas Luftës së Dytë ka punu në do objekte të vogla nëpër ktu në qytet, në Beograd e u konë ni Hotel Jugosllavia ku osht' tash kjo ndërtesa e administratës, te Skendërbeu aty që ka qenë shtëpia e mallrave e reja dhe ka qenë edhe ni Hotel Jugosllavia. Disa kanë qenë objekte ma të vjetra.

Pastaj ka punu si drejtor teknik në Bozhur. E ai me disa shokë tjerë aty ka punu shumë e kanë zvogëlu strukturën e serbëve. Diku kanë qenë, tregojke kur ka ardhë, diku afër 80 përqind kanë qenë punëtorë serbë. Pa marrë parasysh nivelit çfare, pos do punëtorë fizikë kanë qenë shqiptarë. Ka ardhë, 90 përqind kanë qenë shqiptarë pastaj kur osht' penzionu axha. Unë pastaj, masi osht' penzionu ai unë jom punësu aty në hotelieri. Kështu që, ka pasë aty lloj-lloj njerëz, se sistemi ka qenë qasi soji që ka infiltro njerëz aty që të kanë përcjellë e të kanë...

Anita Susuri: A ka pasë për shembull me festu Viti i Ri e?

Sherafedin Berisha: Po, u festu Viti i Ri po osht' festu edhe Viti i Ri i serbëve. Osht' këndu aty ni kangë që dojna, kanë lypë ata të dehurit serbë kanë lypë kokë të shqiptarit për me u çu për meze. Radio Londra ka lajmëru për qat' ekces që ka ndodhë në Prishtinë në qat' kohë.

Anita Susuri: A u konë si problem i madh a?

Sherafedin Berisha: Jo, jo, s'u konë problem i madh, po u përmend ajo edhe në media ndërkombëtare.

Anita Susuri: E nuk janë arrestu ata?

Sherafedin Berisha: Jo more çfartë, "Kemi qenë të dehur". Arsyetimi i tyre gjithë kur kanë bo diçka, naj ekces, "Kom qenë i dehur".

Anita Susuri: E gjatë kësaj kohe që keni punu ktu, ju a keni zhvillu aktivitetin? A keni vazhdu?

Sherafedin Berisha: Në organizatë?

Anita Susuri: Po.

Sherafedin Berisha: Po, po, po, po. As, kërkush as në organizatë nuk e kanë ditë që jom i kyçun në lilegale. Më tregojshin do shokë masnej, masi jom dalë prej burgut ka qenë ni shofer i Fabrikës të Pejës, birra bijke, “Qysh bre”, thojke, “s’më ka kallxu Shera që osht’ i kyçun aty edhe unë isha hi qaty”, (qeshë).

Anita Susuri: S’keni mujtë me i besu ju?

Sherafedin Berisha: Po, jo, se osht’ dashtë me i verifiku. U doke që osht’ djalë i mirë, po nuk e di. Për kohë të burgut osht’ interesant ni detal. Isha në Burgun e Prishtinës edhe kanë qenë dy vllazën u burgosën, të familjes Kopalla, kanë qenë mbiemri. Ai vllau i madh, Halil e ka pasë emrin. Po vjen ni ditë, ni natë kur që merrshin në pytje do vishin pak ma të laghtë pak ma... (qeshë). Po më tregon thotë, “Kur e dhashë”, tha, “deklaratën qishtu ni shoqes”, tha, “ia kishin nxanë ni fletore timen që ia kom dhanë do trakte”. Ajo ka qenë e Pejës. Emrin e ka pasë, kurrë s’e harroj, Sanije Maznikolli.

Tha, po thotë, “Jo”, tha, “më frikësunë po thotë ajo Sanija që jom shtatzanë me Halilin se jom dashnor i tina”. “E ti çka i the?” “Jo more”, tha, “ata e kom shoqe s’kom kurfarë lidhje me to”. Thashë, “O m’u çu Halil, pa të rreh ma zi se ata s’e la”. Tha, “Pse?” Thashë, “Unë jom njeri i martum, me më pasë thanë ashtu ajo çikë: ‘Jom shtatzanë me Sherafin’, kisha thanë ‘Po, për qat’ arsye e ka fletoren tem ajo. S’kemi pasë lidhje kështu të aktiviteteve ilegale’”. Jo bohet, jo s’bohet.

Kur e morën mas ni kohe prapë në pytje edhe e merr ni inspektor, vetëm ni inspektor shqiptar thotë, “Hajde me nënshkru deklaratën çka ke dhanë deri qitash krejt”. Thotë, “Jo, s’e nënshkruj”. Thotë, “Pse?” Thotë, “Se në qit’ vend e kom thanë qishtu e më kanë frikësu edhe duhet me ndrru se nuk e pranoj me nënshkru qit’ deklaratë”. Tha, “M’u kthy po më thotë, ‘E more djalë edhe unë jom shqiptar’. E ndërroi”, tha, “deklaratën”. Mas ni kohe na e bishin “Rilindjen” në burg nganjëherë, nganjëherë jo. Varet çka kish të shkrume.

T’u lexu gazetën, në jetë teme unë kurrë s’e kisha pa atë vajzë, as ai s’më ka përshkru qysh osht’ ajo vajzë. Thashë, “Halil, a osht’ qikjo Sanija?” S’di intuita e shtatë a çka osht’ ajo. Ajo banojke në konviktin e nxanësve te Shkolla Normale, ajo vajza. Gazetartë kishin shku e kishin bo ni intervistë me banues të konviktit për kushtet e kto. Kur u afriu tha, “Po”. P’e kqyrim datën kur osht’ bo intervista e kuptum që ajo kish dalë prej burgut. A beson, ishim gjashtë vetë në dhomë, u çumë kcejshim prej gëzimit, u kapëm për qafe, kcejshim prej gëzimit që ka dalë ajo prej burgut.

Anita Susuri: Domethonë, me qat’ deklaratën e ka pshtu?

Sherafedin Berisha: Që, e ka hjekë [deklaratën e përparshme], që [ka thonë] e kom dashnore edhe për atë arsye ka qenë fletorja ime te Sanija.

Anita Susuri: E jo që osht’ bashkëpunëtore.

Sherafedin Berisha: Jo, që ka qenë në aktivitet ilegal jo. Po pastaj kom dëgju prej disa tjerëve që pas disa viteve prapë osht' burgosë ajo Sanija, se s'kish nejtë rehat (qeshë). Ni detal kështu, ndoshta dola pak prej teme.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Po më intereson fillimisht qysh ka ndodhë arrestimi?

Sherafedin Berisha: Kur jom arrestu nuk kom qenë në shpi, kom qenë te axha, te Xhamia e Perinazit i thojnë këtu, te Taukbashçja. Se ai axha shkoi në Gjermani me gru e me djalë e unë mbeta. Ka qenë, e ka pasë, burrin e qasaj hallës Fetijes, mixha më ka jetu me to, e ka majtë. E kishin shku ata [policia] në shpi, qysh kanë zbulu nuk e di. Edhe s'kom qef me ditë kush qysh osht' zbulu, s'kom qef me ditë. Dikush normal s'ka mujtë me qëndru ka folë.

Kanë shku në shpi edhe s'jom qëllu unë në shpi. Ai bile, ni motër më doket e kap telefonin që me më lajmëru që, "Hajde në shpi". Ia nalë polici, thotë, "Jo". E marrin vllaun tim të tretin në veturë e vijnë te shpija axhës. I rajnë ziles, dola une. Ish koha tamon me u zgju qatëherë me shku në punë. Kur dola, si e çela derën m'i lidhën dur të. Thashë, "A bon veç me u veshë pak? Për çka po më merrni?" "Hajt", tha, "të kallxojmë kur të çojmë atje poshtë". Qaty më morën.

Po nuk i kishin do informata qysh i jepsha unë. "Ku punon?" Thojsha, "Punoj në Grand". A informatat i kishin marrë që punoj në Bozhur. Dikush që më ka njoftë ma herët ndoshta. Deri e vërtetun që jom ai njeri nuk më morën në pyetje. Kur më çunë në dhomë bile, çka osht' ma interesant, në dhomë ish konë edhe Mehmet Hajrizi. Asnjani s'po ia dhojmë të njoftun njani-tjetrit, si të panjoftun krejt. Pa shku edhe dy minuta me thanë erdhën e hoqën Mehmetin prej atyhi, se të ni grupi. Po më thotë njani, "Ish qiky msus", tha, "e kishin torturu goxha shumë", tha, "a e njoftë?" "Jo", thashë, "nuk e kom pa kurrë në jetën teme".

Anita Susuri: Për Mehmetin?

Sherafedin Berisha: Për Mehmetin. Tani vazhdunë hetimet pastaj. Ma keq u sillshin se më kanë marrë në pyetje edhe inspektorat e Beogradit po ma egër janë tregu do shqiptarë aty. Edhe pse ata t'meqëm ata, e shtishin kto me sjellë e vet kqyrshin. Ata janë ardhë kah fundi, me verifiku edhe niherë. Bile njëni kish qenë si i vjetër, kish qenë pak, e pajsha që osht' tepër dhelpër. E po më thotë, tha, "A mujna me bisedu", tha, "serbisht apo shqip?" Thashë unë, "Mujna me bisedu serbisht, po ndoshta më duhet me mendu me gjetë fjalën adekuate se nuk e di niqind përqind", "E", tha, "nuk po marrim përkthyes, mendohu nuk osht' problem".

E unë me qëllim e kisha që kur të ma bon ai pytjen unë me blu niherë atë pyetje edhe m'u mundu me gjetë ni përgjigje adekuate. Ndoshta s'kom mujtë të gjithë me ia qëllu. Ai më bojke pyetje, unë analizojsa çka ma qet' ma mirë, çka ma keq edhe fillojsa me folë me të. E po më tregon ni shok, ai Mustafë Ademi, se ai osht' interesant figura e tij. Ai ka qenë i angazhum prej grupit me punu në Sekretariatit Krahinor, në polici me punu. U shku e ka kry shkollën në Beograd, për me qenë mrena aty në sistem për me pasë informata.

Po më thotë tha, ai inspektori i vjetri, ju thojke atyne, "Çka po boni? P'e sulmoni? Ky i ka dy fakulteta, e ka fakultetin që ia kemi dhanë na edhe e ka fakultetin e Ilegalës. S'muni ju m'u shty me to". Ai kish qenë që i kish marrë në pyetje kta të Informbyrosë, kta të Malit të Zi, e të Kosovës, e të Serbisë. Kish qenë inspektor shumë i urrymë. Unë e hetova që osht', nime ish konë dhelper, kështu, skile. Po korrekt kështu, as me kërcënim as kurgjo, me fjalë. Po kur ta bojke pytjen, ta bojke qaq fjalë me bisht që të shtike llugave. U dashke me pasë shumë kujdes. Nashta kom rrshitë edhe unë najherë, s'kom mujtë me ia gjetë... se ai ish shumë ma me eksperiencë se unë.

Anita Susuri: Ju keni qenë në Burgun e Prishtinës?

Sherafedin Berisha: Në Burgun e Prishtinës edhe në Burgun e Mitrovicës.

Anita Susuri: Qysh ka qenë Burgu i Prishtinës?

Sherafedin Berisha: Burgu i Prishtinës është ni formë gjysmë rrethi. Ka dy kate. Kanë qenë dhomat, valla, shumë ma e vogël se kjo, sa osht' dritarja atje {bën me gisht nga dritarja}. S'di a i ka nxanë dy kreveta. Ni krevet kështu, ni metër e 80 ose dy, dy me pesë ose qashtu diçka. Ka pasë dritaren me, me llamarinë edhe të shpume llamarinën rrathë rrathë. Disa kanë qenë edhe me grila. Nuk kemi pasë banjo mrena, dy herë në ditë na kanë qit' në banjo. Pastrimin ni herë në javtë na kanë çu. E kemi pasë në mes të oborrit, në qosh të oborrit në të vërtetë. Në atë oborrin ku e bojshim shëtitjen ka qenë ni banjo.

Anita Susuri: Jashtë a?

Sherafedin Berisha: Në oborr. Jashtë u dashke me u zhdeshtë, dimër, verë pa marrë parasysh. Me hi me u la edhe me dalë me u veshë jashtë prapë. Kanë qenë disa gardianë...

Anita Susuri: Me ujë të ftohtë sigurisht?

Sherafedin Berisha: Jo, ujë ka qenë të vokët ashtu. Po kanë qenë disa gardianë shumë të poshtër. Kur dilshim prej banjos, na të lagët ishim, mraz ish jashtë, i kishim kaniherë ndodhke me pasë naj plak në dhomë aty, deri u veshke ai plaku bojke nashta edhe 15 minuta nuk na lejshin me hi mrena. Disa

gardianë që ishin ma njerëzorë, “Kapni teshat”, thojshin, “shkoni në dhomë veshnu”. Edhe na çojshin në dhomë me u veshë. E disa kanë qenë shumë të poshtër.

Anita Susuri: Qysh ka qenë ushqimi? A ua bishin në dhomë a?

Sherafedin Berisha: Ushqimi, në dhomë na bishin. Ta bishin për shembull ni të katërten e bukës në mëngjes. Ata dashke, u deshtë me mendu me hongër edhe mëngjesin edhe drekën edhe darkën me qata. Vizita kemi pasë niherë në javtë. Na i bishin edhe rrobat me i ndrru, të pastërta prej shpije.

Anita Susuri: Sa kanë zgjatë vizitat?

Sherafedin Berisha: 15 minuta, gjithqysh. E pastaj më kanë transferu në Burgun e Mitrovicës. Masi jom dënu atje.

Anita Susuri: Ju ‘81-ten jeni burgosë, në cilin muj?

Sherafedin Berisha: Dhedor.

Anita Susuri: Dhedor.

Sherafedin Berisha: Po.

Anita Susuri: Mas sa kohe keni dalë në gjykim?

Sherafedin Berisha: Në gjykim, përafërsisht shtatë muj kur jemi gjykue. Shumicën e atyne anëtarëve të grupit i kom njoftë, po ni pjesë të mirë edhe jo, se sistemi i punës ka qenë në treshe. Jemi njoftë tre vetë, por nëse njëni prej neve e ka njoftë atë tjetrin të treshës tjetër, tjetër nuk e kanë njoftë. Nuk e kanë ditë, se ka funksionu ajo që edhe nëse bjen dikush, mos me ra krejt grupi.

Anita Susuri: E pse për shembull ka ndodhë kjo me i gjyku të gjithë si grupe, ka ndiku? Pse si individ nuk iu kanë...

Sherafedin Berisha: Ka raste të rralla si individ i kanë punu vetëm individualisht, nuk ka pasë po na kemi qenë grup i organizum.

Anita Susuri: Edhe gjithmonë si grup?

Sherafedin Berisha: Edhe aktiviteti ynë ka qenë grupor edhe gjykimi osht’ bo grupor, se me na dënu për të njejtën vepër që e kemi kry së bashku. Se ni individ osht’ ma pak i dëmshëm për ni sistem sesa ni grup.

Anita Susuri: E a ka pasë diçka që ju kanë akuzu që ju s'e keni bo për shembull?

Sherafedin Berisha: Jo. Janë mundu me na detyru me pranu disa gjana, po nëse s'e ke pranë, se nëse... sa ma shumë të pranojsh, ma shumë dënohesh (qeshë).

Anita Susuri: Çfarë aktakuze keni pasë? Jeni cilësu si irredentistë?

Sherafedin Berisha: Nacionalistë, irredentistë, shkatërrues të Vllaznim-Bashkimit.

Anita Susuri: Ishit t'u më tregu për gjykimin.

Sherafedin Berisha: Po.

Anita Susuri: Keni qenë në grup edhe ju kanë dënu...

Sherafedin Berisha: Në grup jemi dënu.

Anita Susuri: Sa vite?

Sherafedin Berisha: Se grupi ynë ka qenë prej, tri vite më duket deri në 15 vjet dënimi. Bile osht' interesant se kur u kry gjykimi po më pytë ai vozitësi që na kthejke, i policisë, po më pytë, "Sa u dënove?" Thashë, "Dy vjet e gjysë". Tha, "Hajgare po bon ti me mu a?" Thashë, "Jo", tha, "Qysh", tha, "dy vjet e gjysë, nuk pat' dënim në tri vjet, ma pak se tri vjet?" Thashë, "Po, po", thashë, "veç qiky dosti yt i ka dy e gjysë, unë dy e gjysë".

Ai polici që po u kujdeske për mue, se më tha, "A je djalë i mirë?" Thashë, "Paj, munohna". Kur hynëm në gjykatë, u deshke me pritë në dhomë tjetër. Tha, "Po t'i zgjidhi durtë veç nëse nuk bon problem". Thashë, "Jo more, çka ka me bo?" Edhe m'i zgjidhi durtë. "Ah", tha, "po e dajna pra burgun për gjystë". E tani po boj shaka po i them atij, "Ky dy vjet e gjysë, unë dy vjet e gjysë" (qeshë).

Anita Susuri: Ju faktikisht pesë vjet i dënum.

Sherafedin Berisha: Pesë vjet po Gjykata Supreme ma ka zbritë në tri vjet dënimin.

Anita Susuri: Meniherë a?

Sherafedin Berisha: Jo, mas dy vjete gati.

Anita Susuri: Edhe keni qenë niherë... krejt kohën në Mitrovicë?

Sherafedin Berisha: Krejt kohën në Mitrovicë, po. Veç kur më kanë kthyer për një katër pesë ditë sa osht' kry gjykimi. Se para gjykimit më kanë çu në Mitrovicë, kur janë kry hetimet. Pastaj, veç për gjykim më kanë kthyer në Prishtinë.

Anita Susuri: Qysh kom ndëgjju prej tjerëve, Burgu i Mitrovicës e ka pasë ni famë të keqe. Po mendoj, secili burg osht' i keq, po ka pasë edhe atë drejtorin...

Sherafedin Berisha: Sherafedin Ajeti.

Anita Susuri: Emnak i juji (qesh)

Sherafedin Berisha: *Imenj* (qeshë) qishtu e ka pasë nifarë theksi.

Anita Susuri: (qesh) Qysh ka qenë ky burg?

Sherafedin Berisha: Burgu i Mitrovicës është në formë të rrethit të plotë. I ka dy kat edhe poshtë e ka edhe podrumin e ka. I ka banjot edhe ka pasë një tri çeli të tjera aty. Osht' si, gati ai kati i podrumit është si gjysmë, gjysmë e burgut jo krejt burgut. E kto dy katet e tjera po. Unë kom shëtitë goxha shumë atëherë, prej dhome në dhomë. Më ka rastisë me nejtë me njerëz të ndryshëm në kohë të fundit. Bile, kom nejtë me ni shok të grupit, atë Nezir Myzhdën, qatje bash në tokë. Mu s'mu ka dokë qaq i hatashëm qysh e përshkrujnë disa. Thojshin, "Me më lshu s'di me dalë". Unë ndoshta që i kom ndrru dhomat i kom njoftë. Edhe vetmitë e di ku janë edhe nuk kom pasë fort problem.

Anita Susuri: E pse ju kanë ndrru dhomat?

Sherafedin Berisha: Po, kaniherë nuk më pëlqejshin shoqnia edhe thojsha, "Me ma ndrru dhomën". Nuk dojshin me ma ndrru, "S'pe marrë bukën". Grevë urie. Ni ditë, dy, "Hajde", thojke (qeshë) ma ndrrujshin dhomën. Kaniherë ma ndrrujshin vet ata qysh dojshin. E më ka ra me ndrru goxha shumë.

Anita Susuri: Po du me ju pytë për dhunën fizike, a ka vazhdu veç në periudhën në fillim të hetimeve a ka vazhdu gjatë gjithë...

Sherafedin Berisha: Sa kanë vazhdu hetimet ka vazhdu edhe dhuna.

Anita Susuri: Shtatë muj.

Sherafedin Berisha: Përafërisht qaq.

Anita Susuri: Në Burgun e Mitrovicës është ndërpre?

Sherafedin Berisha: Në burg kur ke shku veç nëse e ke bo naj vepër diçka me shokë aty ose e ke sulmu gardianin diçka, po kanë përdorë dhunë. Edhe pse, interesant osht', ka pasë shumë djem të mirë edhe prej gardianëve. Na kanë mbrojtë, jo drejt për së drejti, por në distancë kështu na kanë mbrojtë. Edhe ata që kanë qenë disa serbë shumë të poshtër nuk kanë guxu me na keqpërdorë sikur mos të kishin qenë qata shqiptarë që kanë qenë. Kanë qenë shumë djem të mirë. Unë ju di shumë për nderë, jom falënderues ndaj tyne se na kanë ndihmu.

Osht' interesant se edhe informatat kanë rrjedhë prej atyhit nëpërmes tyne. Bojshim ni grevë, për shembull, në Burgun e Mitrovicës për çfarë arsye... se ka qenë ajo Gjyle Krasniqi e Podujevës në burg aty, ajo ka qenë pak ma rrebele. E niherë s'di çka i shtin fjalhtë me ni gardiane aty, i mshon pjatës të ushqimit ajo gardianja, ai punëtori t'u ia dhanë ksajna bukën t'i mshon shkelëm e t'ia gjunë kësajna në trup. E rrehin ata, vijnë ata gardianët edhe e rrehin Gjylën. E na bojmë grevë urie, pse e keni rreh Gjylën. Krejt burgu.

Qarkullojke informata shumë shpejt nëpërmes mureve ose me letra i gjejshe nëpër vende të caktume. Po çka osht' ma interesant, mrena dy dite krejt burgjet e Kosovës kanë bo grevë për të njejtin motiv. Ata dojshin me u çmend kah dul informata. Informata ka dalë prej gardianëve, se na s'kemi mujtë me shpërnda informatën. Telefona s'kemi pasë. Kështu që, ka pasë njerëz të mirë aty që na kanë ndihmu.

Anita Susuri: Këto greva që i keni mbajttë, keni mbajttë edhe për arsye tjera diçka për shembull që ju kujtohet?

Sherafedin Berisha: Zakonisht me kërku ndonjë të drejtë që na takon. Se ishin në rregullore, ata na cungojshin atë të drejtë ose për përdorim të dhunës në raste të caktume. Edhe pse, po thom kanë pasë, falë qatyne edhe gardianëve, të burgosurit politikë nuk janë malltretu shumë. Po edhe të burgosurit politikë kanë qenë si ni lloj edukatori për të burgosurit të tjerë. Kështu që edhe ata, gardianët nuk kanë dashtë me shti cpirra mes neve, se e kanë ditë që na kem fuqi ma të madhe me organizu sesa për shembull ni i burgosun ordiner që ka qenë ose për vjedhje ose për vrasje.

Kur vendosshin të burgosurit politikë diçka, ajo u realizojke. Se ni kohë kemi pasë, për shembull, kur dilshim në shëtitore me i majttë përmrapa durttë lidhun edhe vendosëm mos me i lidhë. U morëm vesh krejt burgu. Qitni prej dhome, i nishim, "Lidhni durttë!" Ju bërtitshin. Se në mes të asaj shëtitores në katin nalt ka qenë ni, i thojshin karauillë aty si vrojtore edhe vëzhgojshin. Dy shëtitore kanë qenë. "Lidhni durttë", "Jo". *Brram* {onomotope} dera u çelke, e nijshim kur kërshitke se të hekrit. Na shtijshin mrena krejt. Ditën e dytë prapë e njejtë, ditën e tretë, s'e bonën fjalë hiç. Edhe na metën durttë shlrë.

Unë thashë, qy sa janë njerëzit edhe kta pa logjikë. Në vend se me ardhë drejtori ose me çu dikond me thanë, "Ka qenë ni keqkuptim, nuk keni nevojë me i lidhë durttë, prej sot jeni të lirë me i majttë durttë zgjidhë", me ju mbetë nera pak vetit po na ju morëm ata me zor. Kështu që, ajo ish meritë e jona, e

kërkujt tjetër. Ka pasë qisi raste të ndryshme, po zakonisht për qisi raste. Ma shumë për shkak të përdorimit të dhunës. Se nuk kemi qenë na sikur në burgjet që kanë qenë sikur kto, për shembull, Dubrava tip i hapur ose burgjet nëpër Serbi e nëpër krejt ish Jugosllavinë. Aty osht' përdorë dhuna edhe për pikë të qefit. Ka pasë shumë raste të rralla naj gardian shqiptar edhe ai nuk ka guxu as me u dëgjue.

Anita Susuri: E a keni pasë edhe, sigurisht keni pasë, edhe vizita në Burg të Mitrovicës.

Sherafedin Berisha: Po, po.

Anita Susuri: Kanë ardhë familjartë e juj...

Sherafedin Berisha: Po, po, kemi pasë vizitat me grila.

Anita Susuri: S'keni guxu me u afri shumë?

Sherafedin Berisha: Jo me u afri po, se ka qenë disa tela shumë të vogël. Nja pesë vizita kah fundi, pak para se me u liru i kom pasë në oborr të burgut, se tjerat krejt kanë qenë...

Anita Susuri: A kanë qenë si vizita grupore edhe të tjerë kanë ardhë?

Sherafedin Berisha: Zakonisht kah tre persona. Mu më kanë ardhë, për shembull, tre familjarë po gruja ka pasë ekstra edhe ni vizitë tjetër me fëmi. Tani na i ndërprejti ai Shera, ma ndërprejti vizitën e fëmive tha, "Jo, s'bon me..." thashë, u përllava me to goxha shumë. Thashë, "Pse?" Tha, "Se trauma", tha, "fëmija", tha, "marrin", tha, "me pa babën në burg". Thashë, "Po kta trauma kanë marrë kur m'ke burgosë", thashë, "tash s'kanë ma çka marrin trauma", thashë, "mos u mërzi ti për fëmi tem". Po, jo. U përllamë, bile përdora edhe do fjalë e shamje. Bile, pritsha veç me më rreh, se e ka rreh ni shok tonin, ni Kadri Osmanin. I ka urdhëru gardianët me rreh se i ka folë ky Shera diçka, ai i ka mshu ktina Sherës boks, i kanë hi gardianët e kanë rreh e kanë bo kështu për spital.

Anita Susuri: E domethonë, ua ndërprejtën?

Sherafedin Berisha: Mu tani vizitën e fëmive ma ndërprejtën.

Anita Susuri: E a patët naj pasojë tjetër që jeni fjalosë me të?

Sherafedin Berisha: Jo, jo. Veç qeshke, interesant. *Imenjače* [Srb.: emnak] qishtu e ka pasë ni shprehje. Ata gardianët veç kqyrshin, thojsha kur të më sulmojnë edhe të më rrehin. Po unë e humba vetëveten në atë moment.

Anita Susuri: Po më intereson edhe familja juj çfarë gjendje ka qenë, për shembull edhe ekonomike kur ju jeni burgosë?

Sherafedin Berisha: Jo krejt e keqe, po edhe e mirë jo. Gruja atëherë ka qenë me dy fëmi, ka jetu me prindtë e mi. Baba ka qenë penzionist, njani vlla, dy vllaznia në të vërtetë kanë punu. Njëni ka qenë i martum, njëni jo.

Anita Susuri: A keni qenë në bashkësi a?

Sherafedin Berisha: Në bashkësi krejt kemi qenë, në bashkësi familjare. Nuk kemi qenë edhe shumë keq. Më kanë ndihmu edhe axha edhe baba i nusës ka ndihmu disa herë. Kështu që, nuk kom pasë ndonjë mungesë diçka sa i përket, as veshmbathjes po edhe ushqimit që kanë sjellë. Sillshin disa gjana ushqimore ekstra të familjes.

Anita Susuri: Qysh e ka pritë, për shembull, bashkëshortja juj, prindtë e juj burgosjen?

Sherafedin Berisha: Gjyshja e ka pritë ma së randi, pastaj edhe nana. Baba mirë, mirë e ka pritë. Edhe bashkëshortja, qysh kom mendu, shumë mirë e ka pritë. Bile kur më kanë dënue pesë vjet, tha, “Jom shliku kur të kanë thanë pesë vjet që të kanë dënu”. Thashë, “Pse?” Tha, “Unë mendova mos po të lirojnë”, e tha, “po ta ngjesin naj epitete që je najfarë tradhëtari”. Më erdh shumë mirë.

Anita Susuri: E në vizita shpesh kom dëgju, tash unë po i përmendi ato që kom dëgju ma herët, që kur ju kanë pru diçka nuk ju kanë leju me i marrë ato...

Sherafedin Berisha: Shumicën e gjanave po.

Anita Susuri: Ka pasë konfiskime.

Sherafedin Berisha: Po, ka pasë, po shumicën e gjanave po [i ke marrë]. Nuk kanë leju, për shembull, me të pru çaj në qese.

Anita Susuri: Pse?

Sherafedin Berisha: Se u deshke tani me të pru edhe ujë të nxehtë (qeshë), s’kish ku me vlu. E gjana ushqimore të paketume kto po. Pula të pjekta, po kanë pru të familjes, kanë pru edhe pite. Bile ni rast, më patën pru, kishin marrë do qumësht prej njënit të deleve e kishin bo do long tv familjes ni, nifarë kante goxha të madhe, ni javë ditë na s’kemi marrë gjellë hiç, veç bukën. Thojshim atyne, “Ana bukën, gjellë s’po dojna”. Veç me long e kemi hongër. Se ishim përmallu me hongër me long (qeshë). Diçka ma të lehtë. Edhe pse ushqimi në Burgun e Mitrovicës ka qenë shumë ma i mirë se në Burgun e Prishtinës, kualiteti ka qenë shumë ma i mirë.

Shumë i poshtër ka qenë ai Sherafedin Ajeti, po ushqimin... se osht' ndrru. Para tina ka qenë ni tjetër, Sokol, s'po më kujtohet mbiemri, ushqimi ka qenë ma i dobët. Ky e përmirësoi ushqimin. Diciplinë ka pasë ma shumë edhe ni gja ka qenë interesate se në kohën e atij Sokolit, gardianët veprojshin shlrirë. E rrehshin dikond, e bojshin probleme pa e pytë drejtorin hiç. Kur ka ardhë ky s'kanë guxu kurrë me të sulmue pa qenë edhe drejtori prezent. E ka pasë nifarë rregulli. Ka qenë i poshtër shumë, po ka pasë rregullat e veta.

Anita Susuri: E çfarë ushqimi ka qenë, për shembull? Gjellna?

Sherafedin Berisha: Po, në mëngjes kemi pasë zakonisht ose ndonjë marmoladë të vogël edhe margarinë ose ndonji ve të zime ose edhe ndonjë virshlle. E për drekë kemi pasë ushqime të ndryshme dhe shumicën e rasteve kanë qenë me mish, nëse nuk gabo. Tash s'po jom fort i sigurt ose të shtunën ose të dillen nuk ka pasë mish, tjera ditë ka pasë gjithmonë. Edhe darka ka qenë e lehtë, nuk ka qenë diçka shumë kalorike po, për shkak se ne nuk kemi pasë aktivitete fizike, na ka mjaftu edhe ajo. Nuk muj me thanë që ka qenë diçka shumë keq edhe pse në burgje tjera ndoshta ka qenë ma keq sesa unë që kom përjetu.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: E qysh ka vazhdu kjo koha e ju? Me çka jeni marrë a keni pasë punë me bo diçka aty? A keni lexu?

Sherafedin Berisha: Unë kom qenë tonë kohën në burg hetues. Me lexu kemi pasën, ka pasë ni bibliotekë të vogël aty, po edhe na kanë leju në disa raste, disa raste jo gjithmonë me na sjellë libra edhe prej jashtit. Bile ni rast jom çuditë, ni i burgosun nga Ferizaji ni valixhe plot libra ia lejun. Diku 80 përqind e tyne kanë qenë botime të Tiranës. Jom befasu qysh ka hi ajo valixhe, kush e ka lëshu nuk e di. Kënaq jem t'u lexu.

E patëm bo bile ni rregull se kemi qenë aty, ka pasë të burgosur edhe për vjedhje edhe për vrasje edhe e patëm bo ni ligj. U morëm vesh, u ulëm krejt dhoma. Kemi qenë në ni dhomë të madhe, kemi qenë nantë vet a dhetë. "A e bojmë ni rregull?" "E bojmë". "Veç s'ka me thy kërkush". Prej mëngjesit deri në drekë kena me lexu, kush nuk guxon asni fjalë me lshu. Prej dreke deri në darkë, bo çka të dush, ndaq lexo, ndaq luj.

Kemi pasë mundësi me lujtë domino, shah. Bile, ni kohë patëm fillu me lujtë edhe ajo loja kapuqas që u konë. Ka qenë njëni, ka qenë, shumë ka pasë prirje për m'i këndu kundërshtarit që e hupke lojën me fjalë rënduese, pak kështu mirëpo jo tepër. Po ka qenë shumë i mirë. Kemi lujtë edhe kështu loja, po edhe me lexu kemi lexu.

Anita Susuri: A ka pasë komunikime, për shembull, me diskutu për çashtjen, për politikën, për sistemi apo jeni rujtë?

Sherafedin Berisha: Po mvaret edhe prej rrethit ku ishe me çfarë njerëz. Mas ni kohe, ti i njifshe për afërsisht kush janë e çka janë. Kemi bisedu, po jo me emra, për shembull, me dikë po kështu të përgjithësime.

Anita Susuri: Ju thatë që mas, mas sa kohe ju ka zvogëlu dënimi ju?

Sherafedin Berisha: Diku mas dy vite e gjysë për afërsisht.

Anita Susuri: Qysh ju erdh juve ky njoftim?

Sherafedin Berisha: Me vendime prej Gjykatës Supreme të Kosovës që më osht' zvogëlu dënimi. Ju ka zvogëlu edhe nga katër-pesë vetëve aty në grup tonin. Po ka pasë edhe raste që osht' rritë dënimi i Gjykatës Supreme. Më kujtohet ni rast, njëni u përgatit kish me dalë qat' ditë sipas gjykimit të shkallës të parë edhe po hapet dera ai me valixhe në dorë po don me dalë. Po i thotë gardiani, "Prit pak, nënshkruje qitu", tha, "Çka?" Tha, "T'u ka vazhdu edhe për gjashtë muj". Po ka qenë diçka, lajm shumë i keq edhe ish i ri. M'u dhimt, po çka me bo. Ka pasë edhe asi raste.

Anita Susuri: A jeni gëzu kur ju ka zvogëlu? Dy vite ju kanë zvogëlu?

Sherafedin Berisha: Po, dy vite. Po normal e ndin nifare kënaqësie edhe pse të vike keq me shpreh ndoshta prej tjerëve. Po normal, e ndin pak ni lehtësim, se nuk muj me thanë tash që e kom pasë njëjtë si ashtu, si ashtu. Edhe pse unë e pata, kur para se me ma shqiptu dënimin, unë u pata përgatitë deri në dhetë vjet me më dënu. Kështu vetën e pata përgatitë deri në dhetë vjet mos me pasë problem, mbi dhetë ndoshta m'kish ardhë pak ma vështirë. Kur m'ka thanë pesë, m'u ka dokë me të vërtetë sikur me më thanë po lirohesh. Se s'mu dok dënim i madh në krahasim me tjerë shokë.

Anita Susuri: Ju e keni ditë datën e saktë kur keni me u liru? A e keni ditë?

Sherafedin Berisha: Po, po. Jo, se më kanë liru pak para kohe. Unë e kom pasë me 20 dhjetor, më kanë liru me 2 dhjetor.

Anita Susuri: Qysh ka qenë qajo ditë, a ju kujtohet?

Sherafedin Berisha: Jom befasue, s'e kom pritë qat' ditë.

Anita Susuri: Të kanë ardhë ndoshta në dhomë...

Sherafedin Berisha: Erdhën në dhomë më thanë, “Mblidhi çka i ki gjanat tua edhe dil jashtë”. Bile unë po du me i lonë do gjana, m’ju lonë shokve. Ni plak, “Jo, mos le kurgjo ktu”. Thashë, “Pse?” Tha, “As krytë mos e kthe kur të dilsh”, tha, “se kthehesh prapë ktu vjen” (qeshë). Se p’e lidhi ktu qitash ni rast gjyshja ime ka qenë në shtrat, se ka qenë smutë, ajo kish thanë më tregojshin pastaj të familjes, “Nuk vdes pa ardhë Sherafi. Mjafton veç me kalu kah dritarja, muj me dhanë shpirt”. Fatmirësisht unë nejta dy javë me to edhe vdiq pastaj.

Më ka dashtë tepër, tepër më ka dashtë se kom qenë fëmija ma i madh në familje. Baba im e ka pasë ni fëmi para meje, i ka vdekë i vogël e tregojshin edhe hallat edhe këta, “Na u doke që edhe zogjtë e malit po knojnë prej gëzimit”. Dy hallat e mia tha, “Nuk e lejshim nanën tane as me të la mirë, ia shtishim durtë e të lajshim ty. Edhe çdo ditë të matshim sa po rritesh”, se me nifarë toje, “çdo ditë”, tha, “u rritshe sa ni kokërr gruni”. E janë do gjana që po emocionohna kur...

Anita Susuri: Po qat’ ditë që keni dalë prej burgut, s’i keni lajmëru kërkujt? Qysh jeni kthy deri në shpi?

Sherafedin Berisha: Kish, i kisha do të holla që i kisha. Se na dërgojshin të holla për me na ble duhon ose do gjana tjera aty në burg. Hypa në autobus aty në Mitrovicë erdha në Prishtinë deri në Stacion të Autobusave. Në Stacion të Autobusave deri që erdha ktu te gjimnazi përpos ni, ka qenë ni jevg që ka punu në ujësjellës, ka punu me mixhën tem, ka qenë koleg aty. Të vetmin njeri që e kom njoftë rrugës prej autobusit ka qenë ai. Kur kom hy në rrugë aty, e takova ni djalë të fqinjëve aty, “O Sheraf, je ardhë a?” “Po”. Halil e ka emrin ai djali.

Unë hyna, i rash ziles *bërr e bërr e bërr* {onomotope} kështu pa ndërpre zilen. A kish thanë nana, “Po kush u tranu po i bjen kështu ziles, do me djeg”. E para se me i ra zilës unë, i kish la do rroba në banjo edhe ish nal, e ka ni dritare përballë dyrve të hymjes edhe po kqyrë. E i kish thanë, “O mos e kqyrë badihava dritaren, se hala s’e ka vaktin me ardhë ai”, thotë. Ajo gruja [ima] i kish thanë, “Po nashta mos po vjen bre, a din”. E veçsa ishin ulë me hongër bukë i bi unë zilës e del. S’di më doket njani vlla ma çelë derën. Kur më shohin, tani u prish buka.

Ai Halili hin, se hallën e kom pasë njënën të martume aty afër. Thotë, “Oj aba Fahri”, thotë, “u ardhë Sherafi”, “Le bre”, thotë, “çfarë Sherafi”, thotë, “Vallai erdh”, thotë, “qe qito pare m’i ka dhanë”. Se unë e shtina dorën në xhep, krejt paret që i pata ia lëshova në dorë (qanë). Më fal. Diqysh janë disa se për shkak të familjes. Jo, jo, s’o problem, vazhdojmë. Po kur po e kujtoj gjyshen, e këto në andërr pak...

Anita Susuri: Deshta me vazhdu pak me folë tash për periudhën kur keni dalë prej burgut, shumica kanë pasë vizita, kanë pasë mysafirë, ka qenë si ni lloj neje që u është bo...

Sherafedin Berisha: Po.

Anita Susuri: A ka qenë edhe te ju kështu?

Sherafedin Berisha: Janë pritë si heronjë ata njerëz. Po mas ni kohe pastaj fillunë edhe të nënçmoheshin dikur. Po në fillim janë pritë si heronjë. Po kanë ardhë lloj-lloj njerëz, kanë ardhë njerëz edhe me detyrë aty për me dëgju çka po flitet, çka po bisedohet, ka pasë edhe asi raste. Eh ai Ron Govori që thashë, ata gjyshja ime e ka pasë djalë të motrës. Masi vdiq gjyshja, erdh ai për ngushëllime. Si më ka pa në derë, “O ku je o irredentist, ku je o i poshtër i botës, na ke prishë Vllaznim-Bashkimin”, ai me ironi i thojke kto krejt. E tani kur erdh më përqafoi. Ka qenë gjana interesante edhe atëherë në atë kohë edhe pse ish pak krizë edhe ekonomike. Ka pasë raste që s’kom pasë pare as për duhon po u gjindshin prapë.

Anita Susuri: E mas burgut thatë që në punë nuk ju kanë pranë?

Sherafedin Berisha: Jo.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu tani jeta ju? Edhe sigurisht tani ni kohë ju kanë përcjellë?

Sherafedin Berisha: Po, sigurisht. Jom i bindun se kom vrejt disa shenja. Po nuk më kanë pranë në punë. Tani ni sekretar ka qenë te kjo Ndërmarrja për Mirëmbajtjen e Banesave. Nëpërmes ni mikut tim ma ka mundësue me punue si punëtor fizik në Eurgens aty. Ai i vetmi ka qenë që e ka ditë që kom qenë i burgosun, tjetër s’kanë ditë aty në organizatë kërkush. Kom punue nja tetë muj si punëtor fizik, pastaj ni mjeshtër aty i molerëve tha, “Pse s’po shkon me marrë ni diplomë”, tha, “e hajde”, tha, “si moler edhe e ki pagën ma të mirë, punën ma të lehtë”. Pata shku, ajo ka qenë shkolla e natës që i thojshin. Shkova e dhashë provimin si moler. Kom punu ni kohë si moler. Tani më largun prapë prej punës se sigurisht rrjedhi informata edhe më përjashtun prej punës. Punojsa privat, ku gjejsa si moler.

Anita Susuri: Po më duket që thatë e kom vrejtë që m’kanë përcjellë, qysh e keni vrejtë kta?

Sherafedin Berisha: Po ishin disa njerëz që osht’, nuk osht’ normale me rastisë i njeiti njeri gjithmonë në vend ku je edhe ti. Pak edhe përvoja, pak fiton njeri edhe në burg, edhe burgju osht’ ni lloj shkolle. E për me, me u detyru m’u largu isha me ni djalë të dajës dojshim me shkue në Preshevë se nuk u gjindke në qat’ kohë sheqer, nëse s’gaboju ktu në Kosovë. Hajde po shkojmë p’e marrim atje. Na nalën policia në Gjilan edhe na kontrollun. Ai punojke në Bashkësinë Islame, kish m’i çu do revista në Preshevë. Na murrën, na i morën ato emrat, mbiemrat ato. Kur më mori ni inspektor në pyetje. Ai e dike shqipen, serb ish kanë, po e dike shqipen shumë mirë. Se i lexojke ato edhe ia përkthejke atyne tjerëve çka po shkrun.

Edhe pse ka qenë revista fetare ka pasë diçka edhe politikë në to, po më thotë, “A ke qenë ndonjëherë në burg?” Thashë, “Jo”. Tha, “Pse po rren?” Thashë, “Jo de, s’jom konë, qit’ burg s’jom konë kurrë, në Burg të Gjilanit”, “A e njeh”, tha, “Hydajet Hysenin?” Thashë, “Po”. Edhe tentoju me mi bo disa pyetje. Tha,

“Mirë”, tha, “jeni të lirë po”, tha, “nesër”, tha, “si të shkojsh”, tha, “me u lajmëru në Sekretariat të Punëve të Brendshme në Prishtinë”, “Ani”, thashë, “në rregull”. Masi më lshove, vet me veti, s’të mi ke pa as ti as sytë. U detyrova me dalë jashtë. Shkova tani në Austri punova ni kohë...

Anita Susuri: Keni shku vet fillimisht?

Sherafedin Berisha: Veç vet. Pastaj u ktheva prej Austrisë edhe shkova në Gjermani. Mas ni kohe tani i thashë grusë, “Merri fëmitë e hajde se veç vet as s’ma sheh shpija fort, as unë s’ia shoh hajrin ktu. Kështu që, familjarisht kom mundësi me pasë ni lloj kapitali”, se jepshin ato ndihmat e çka të punoj kështu, ato mujsha m’i nimu edhe familjes.

Anita Susuri: Në cilin vit keni shku kështu me familje?

Sherafedin Berisha: ‘93, 1993, kanë ardhë edhe gruja.

Anita Susuri: Keni pasë kontakt ktu me grupin?

Sherafedin Berisha: Ma shumë kom komuniku me Mustafë Ademin në Zvicërr edhe me disa të burgosur, por jo të grupit në Gjermani. Jom mundu me kontribu sa kom mujtë.

Anita Susuri: Çfarë aktivitete për shembull?

Sherafedin Berisha: Për shembull, ka qenë ajo “Tre përqindëshi”. Në qat’ qytetin ku shkova unë, tani ish aty ni djalë i dajës edhe ai më bindi më dalë, se hala isha në dilemë a me dalë a jo, mas Austrisë prapë me dalë në Gjermani. Po i pys, prej krejt shqiptarëve që ishin aty, veç njëni pagujke “Tre përqindësh”. Po për nja dy javë ditë me ndihmën e ni tjetrit që ish në tjetër qytet, i kemi bo të gjithë me pague. Vet kanë qenë edhe dy jevg, njëni ka punu, njëni jo. Një që s’ka pagu se të gjithë i kemi shti me pagu “Tre përqindëshin”.

Anita Susuri: E atje a ka pasë ksi organizatë ose naj grup ose qysh?

Sherafedin Berisha: Kanë qenë kto Klubet Shqiptare, në kuadër të klubeve tani punojshin edhe grupe të ndryshme. Po partitë ktu që ka qenë LDK-ja e këto, Lëvizja Popullore. Tash varet prej preferencave u antarësojshin edhe njerëzit.

Anita Susuri: Ju keni marrë pjesë edhe në do demonstrata që i organizojshin jashtë?

Sherafedin Berisha: Po. Në Austri, në Grac kemi qenë diku nja 50 shqiptarë kështu që pak ma të ri. Aty e kem organizu ni demonstratë në përkrahje të Kosovës. Kemi marrë lejen prej policisë. Në banesën ku kom banu i kemi shkru të gjitha pankartat edhe kemi dalë. Çka ka qenë ma interesant, ne dilshim në

demonstratë e krejt kish raste mas tre-katër dite udhëtojsin njerëzit, vishin për Kosovë me autobus. Po s'di, nuk dishim me u frikësue. E pastaj edhe në Gjermani kam marrë pjesë në demonstratat atje në Bonn e Duuseldorf.

Anita Susuri: E çka keni shkru nëpër pankarta? Kosova Republikë?

Sherafedin Berisha: Po, po, po. Qato. Kosova Republikë, Liri për popullin shqiptarë, qito gjana të zakonshme që kanë qenë.

Anita Susuri: E gjatë periudhës kto vitet që kanë qenë edhe ma të vështira që u rëndu situata '97, '98, '99...

Sherafedin Berisha: Unë kom qenë në Gjermani.

Anita Susuri: Po familja ju? Prindërit e ju? a kanë qenë gjallë?

Sherafedin Berisha: Po, po.

Anita Susuri: Në Kosovë kanë qenë?

Sherafedin Berisha: Po

Anita Susuri: Keni pasë kontakte a qysh e kanë përjetu ata?

Sherafedin Berisha: Me telefon ma shumë. S'di interesant, ju kanë përshtatë qatyne kushteve edhe ata.

Anita Susuri: A kanë qëndru ktu në Prishtinë?

Sherafedin Berisha: Në Prishtinë edhe gjatë luftës kanë qëndru fëmijtë. Nana u paralizue, ka pasë sulm në tru e nuk ka mujtë me lëvizë ni pjesë të trupit, baba ka mbetë. Ni vlla që ka qenë ktu me kta edhe ai ka dalë jashtë në Maqedoni, pastaj ka ardhë në Austri. Se njanin vlla e kom pasë në Austri ka punue e ka shku te vllau aty. E unë kom qenë në Gjermani. I kom vizitu tani prej Gjermanisë në Austri edhe pse s'kom pasë të drejtë me shku në Austri, po kom shku qashtu në të zezën.

Anita Susuri: E kur kanë fillu bombardimet këtu, qysh e keni pritë qata?

Sherafedin Berisha: Me kënaqësi e kemi pritë edhe pse me ni dozë pak të frikës. Se e kemi ditë që nuk kanë me lonë lehtë serbët. Kurgjo kurgjo, a din që thojnë, ni fjalë popullore që thotë, "Idhnohu

gomarit e sillu samarit. Idhnohu samarit e silli magarit”. Edhe aty idhnohu me ata që po bombardojnë e gjuju popullatës të mjerë e të pambrojtur.

Anita Susuri: Prindërit e juaj edhe gjatë bombardimeve kanë qëndru?

Sherafedin Berisha: Po.

Anita Susuri: Nuk i kanë largu prej shpisë?

Sherafedin Berisha: Jo, jo. Nana ka qenë e paralizume, i kanë pasë dy pleq. Unë kom mendu që veç kur t’i vrasin, t’i lanë qaty, po fatmirësisht jo. I kishin shku policët nja tri herë, qysh m’ka tregu baba, i kanë pa që, “A ki refugjatë?” “Jo”. Se kanë qenë do familjar, jo të dajve të grusë e do të afërm të grusë të mixhës e kështu kanë nejtë kah disa ditë edhe janë largu. Po kur kanë qenë ata, s’ka qëllu kërkush aty.

Anita Susuri: E për shkrimin, qysh, sigurisht në televizion, në media e keni marrë vesh? A qysh?

Sherafedin Berisha: Po, i kom pa kto storiet e ndryshme. Bile osht’ ni rast interesant me ni, kom pasë kontakt me gjermanë, me shumë. Po i thom njanit, thashë, “Shife”, thashë, “ni fqinjë i imi ka qenë ushtar i Hitlerit. E ka pasë”, thashë, “vulën ktu” {bën me dorë te krahu} është e vërtetë. Edhe thashë, “Kur ka, kur e kanë hup luftën gjermanët, kanë fillu m’u tërhjekë kanë thanë, ‘A po vjen me neve edhe ti në Gjermani?’ qatij fqinjit tim, ai thotë, ‘Jo’, ‘Mirë’, thotë, ‘vetëm mbaje mend ka me ardhë koha edhe niherë pa shkelë kama e ushtarit gjerman në Kosovë nuk ka me mbetë’”.

Kur përfundoi qatëherë lufta, ushtartë e parë në Prizren kanë hi gjermanët. Po më thirrë ai gjermani në telefon tha, “Hej Berishë”, tha, “ma kishe thanë”, tha, “të vërtetën”. Thashë, “Pse?” Tha, “A i pe ushtartë gjermanë në Prizren?” Thashë, “A t’kom thanë që ushtari gjerman ka me u kthy”, thashë, “i meçëm ka qenë ai oficeri gjerman”. Kështu, janë do raste kaniherë interesante. Se m’ka ndodhë, nashta po dal pak prej teme, dy raste shumë interesante që m’kanë ndodhë që nuk kisha besu që mujnë me më ndodhë.

Isha niherë në Gjermani t’u e prit autobusin me shku me ni qytet tjetër. M’u afru ni plak tha, “Mirëdita!” “Mirëdita!” “A ki”, tha, “ni cigare?” Thashë, “Po”. Ia dhashë. Po i nxjerrë 50 fening me ma pagu cigaren. Thashë, “Çka po don?” Tha, “Po t’i dho për cigare”. Thashë, “Unë nuk ta shita, unë ta dhashë”. Tha, “A shqiptarë je a?” Në bazë të atij gjestit. Thashë, “Po”. Po bisedoj me to edhe unë i ngacmojsha kaniherë gjermanët, thashë, “Mos ke qenë ushtar i dajës?” Tha, “Cilit dajë?” Thashë, “Dajës Hitler”, se pleqt tanë Hitlerit i kanë thanë dajë, se koha e okupimit gjerman për shqiptarë e Kosovës ka qenë liri. Se e kanë largu sistemin e mbretit të Jugosllavisë, osht’ hapë administrata në gjuhën shqipe. Faktikisht ka qenë ni lloj lirie.

Tha, “Jo, s’kom qenë, kom qenë në Kroaci pak”, tha, “po intendant”, tha, “kom qenë”. Thashë, “Unë s’po të pyti çka ke punue”, thashë, “po a ke qenë ushtar?” Tha, “Po”, tha, “serbtë”, tha, “janë shumë të pabesë. Sikur ai qeni tinzak”, tha, “nuk të sulmon përpara, po përmas”, tha, “të kafshon, në pulpa të kamës”. Erdh autobusi unë po shkoj. Tha, “Ku po shkon? Rri bojmë muhabet”. Thashë, “Jo”, thashë, “a po don me më prishë me gru a?” (qeshë) E shkova.

Edhe ni rast tjetër, krejt tjetër vend, krejt tjetër situatë, Isha me grunë në Tiranë, osht’ ni treg kah qendra aty është në Tiranë edhe t’u shku rrugës, plot njerëz rruga. Po vjen ni plak, më tejkaloi kështu ni plak me atë, me sheshir kështu të mirë. Më tejkaloi mue edhe m’u nal përpara. Edhe më përshëndeti me grusht {vë grushtin tek koka}. U nala e kqyra t’i koqitna edhe une kap {e vendos grushtin te koka}, e përshëndeta edhe unë. Veç ka buzëqesh, u kthy edhe eci. As nuk e foli asni fjalë as kurgjo. Krejt ata njerëz përreth kanë fillu me qeshë. Qito dy raste unë s’muj me i shpjegu qysh. Bile qiky i Shqipnisë, jom befasu.

E po më thotë gruja, “Çka?” Thashë, “Po e ka ditë që e kom dashtë Enver Hoxhën atëherë edhe...” (qeshë). Se fola ndoshta palidhje, mos ju pëlqeftë mundeni me hjekë. E osht’ interesant se më kanë ndodhë qito gjana shumë interesant.

Anita Susuri: Po më intereson tash mas luftës, kur keni ardhë? Kur jeni kthy në Kosovë?

Sherafedin Berisha: Jom kthy, domethonë, nja pesë-gjashtë muj masi kanë hy trupat. Bile shkojsha aty në atë, i thojnë ata *auslander*, me të hujtë që mirret ajo zyrja. Thojsha, “Me më kthy ma shpejt”. Thojke, “Oh jo, deri t’i rregullojmë dokumentet”. Knej mjeku, se e kom pasë ni infrakt atje, e kom ni stend ngjitën. Ata thanë, “Pa e bo edhe ni kontrollë, nuk guxon me shku”. Unë shkojsha atje, ma bojke ni gjermane aty që punon, “Krejt”, thojke, “po vijnë po qajnë, ‘Mos na kthe!’ ti m’ke lodhë, ‘Hajde kthem ma shpejt!’”. Po më kthyn tani, u ktheva. Erdha se prindtë mbetën veç aty dy. Dy vllaznia ishin jashtë.

Ia pata dhanë ni betim vetvetit nëse më vdes njani prind ose dytë nuk hapi të pame në Gjermani, me thanë hajde me më ngushëllu dikush. Prej katër djemve, thashë, asnjëni aty me qëllu jo, pa u kthy s’e lo. U ktheva. Bile, punojke gruja ni shpi pastrojke, ai ka qenë francez e i martum për gjermane. “Lema”, thojke, “djalin, unë e merr përsipër me shkollu, me banesë me krejt”. I kish katër firma të reklamave. I kish nda, i kish parcializu thashë, “Pse i ke nda? Pse s’e ke bo veç ni firmë?” “Jo”, tha, “se me bo veç ni firmë”, tha, “po bojnë sindikatë. Kështu deri në dhetë punëtorë s’mujnë me bo sindikatë. E unë”, tha, “i kom në dorë ata, jo ata mu”. E thojke, “Lema djalin, unë krejt për punësim e krejt ka me u kujdes”. “Jo, s’muj”.

Anita Susuri: Çfarë moshe i keni pasë fëmijtë atëherë?

Sherafedin Berisha: Po, djali ka qenë 19 vjeçar. Vajza e madhe ka qenë e martume edhe dy tjerat kanë qenë ma të vogla. Njëra e ka, '84-tën, po, '84-tën ka lind njëna, njëna 2006-tën.

Anita Susuri: Dallim i madh.

Sherafedin Berisha: Po, qajo fëmija i pleqnisë. Qato e kom në shpi veç, tjerat krejt i kom jashtë.

Anita Susuri: E mas luftës ktu, qysh e gjetët Kosovën? Qysh u sistemutë prapë në jetë ktu?

Sherafedin Berisha: Për besë ishte nifarë tollovie pak në qat' fillim. Nuk u dike kush çka po bon, s'kish rregull as në komunikacion. Po prapë komunikojshin njerëzit, nuk kish edhe probleme të mdhaja. Bile në qat' kohë më thirri dikush i qytetit të Gjermanisë, tha, "Berishë", tha, "a muj me ardhë në Kosovë?" Thashë, "Hajde shlrë", thashë, "unë të garantoj". Erdh nejt dy javë ditë. E kur dilshim në qytet thojke, "Ai qy çfarë tollovie as s'po dhojnë shenja kur po kthehen me vetura, po i grahin shpejtë, as s'po i bijnë burijave". Thashë, "A po e paramendon", thashë, "ti Gjermaninë veç dy ditë pa polici, pa rregulla, pa shtet?" "Eu", tha, "bohet", tha, "haos", tha.

"Ktu", thashë, "ktu", thashë, "s'ka as polici, s'ka as ushtri të rregullt. Ai mos me u frikësu që e vras me armë të rregullt me më sulmu në shpi edhe prej shpije m'qet. Ka", thashë, "lloj-lloj njerëz". Tha, "Ashtu ki të drejtë". Bile edhe ni rast po më thotë, "Berishë, shihe", tha, "krejt po flasin gjermanisht", nime shumë njerëz flisnin gjermanisht qatëherë rrugës. Tha, "Po bjen Europa shumë ndihma", thashë, "Po", thashë, "faleminderit shumë, veç e keni bo ni gabim". Tha, "Çfarë gabimi?" Thashë, "Ku i keni gjetë qita thasë të shkym", thashë, "deri po vijnë paret prej Europës po rrjedhin udhës dikund", thashë, "e kur po vijnë ktu qata thasë po i hapin po jesin disa, po pshtetën nëpër muret e thesit", thashë, "po t'i gjuhen qata hajnat që i keni pru ju, e hajnat tonë", thashë, "popullit të ngratë s'po i jetë kurgjo". Më kqyri, tha, "Ki", tha, "të drejtë".

Anita Susuri: Ju më duket thatë që në Hotel Grand keni vazhdu me punu.

Sherafedin Berisha: Po, kom punu. Herën e parë më refuzunë. Kur i thotë njani atij drejtorit të Grandit, "Po a e din kush osht' Sherafi?" Thotë, "Jo", qishtu ia tregon historinë time. Më pranunë. Po s'më pranunë si depoist, po zëvendës depoisti. Tani ma caktunë ni, si depoist i inventarit diçka, po mirë u punësova. Nuk ka qenë rroga e keqe deri u privatizu. Kur u privatizu u knaq tani krejt (qeshë).

Anita Susuri: Deri në cilin vit po i bjen që keni punu?

Sherafedin Berisha: 2006-ten nëse s'gabo.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu tani jeta juj? A jeni angazhu naj kund?

Sherafedin Berisha: Ni kohë tani s'kom punu kurgjo, kom punu kaniherë qishtu si moler.

Anita Susuri: Me zanat.

Sherafedin Berisha: Me zanat pak.

Anita Susuri: Po më intereson, po kthehna pak mrapa po po mendoj që osht' e rëndësishme edhe qikjo. Kur keni qenë në Fakultet Ekonomik, ju ka ndërpre...

Sherafedin Berisha: Po.

Anita Susuri: Edhe s'keni pasë ma të drejtë shkollimi, a osht' qishtu?

Sherafedin Berisha: As s'i kom provu, jo, veç s'kom shku. Bile mas luftës tash e takova ni, ka vdekë ai, Rifat Blaka, ka vdekë ai tash ka qenë profesor i ekonomisë politike. Tha, e takova në Gërmi isha në shëtitje me shoqen, tha, "Pse s'po vjen", tha, "me vazhdu fakultetin?" Thashë, "Hajgare po bon me mu?" Tha, "Pse?" Thashë, "Po unë e kom dhanë", thashë, "vitin e parë, e kom dhanë Matematikën 1, du me dhanë 2-shin", thashë, "qe sa vjet kom pauzu", thashë, "u ndryshk truni", "Hajde more se e jep", "Jo", thashë, "se m'kanë hupë dokumentat", "Hajde", tha, "në fakultet t'i gjoj". Nuk shkova.

Anita Susuri: Zoti Sherafedin, nëse keni edhe diçka për fund që doni me përmend ose me tregu.

Sherafedin Berisha: Po kisha me thanë se, atëherë kur kemi qenë të organizum në lilegale, ideja jonë edhe qëllimi ynë ka qenë bashkimi kombëtar. E ai larg osht' me u realizu edhe pse shumë vetë kanë thanë, ka me u bo e s'ka me u bo. Bile shpesh herë tham, bashkimin kombëtar ka me e bo as qata që e dun as ata që s'e dojnë bashkimin kombëtar. Kanë me bo ata që s'e dijnë çka osht' bashkimi kombëtar, do gjenerata pak mas neve, po jo shpejt. Po a ka me u bo? S'ka qare pa u bo se osht' e pamundshme ni trup me u nda e me jetu ndamas se nuk mundet me qëndrue. Kështu të bashkum jemi ma të fortë, ma të mirë. Jem populli ma i mrekullueshëm po jemi edhe ma problematik.

Bile, bojsha hajgare ni ditë me ni hoxhë, thashë, "Hoxhë", thashë, "m'u ka mushë menja diçka veç", thashë, "nashta s'po hi në gjyna", tha, "Çka?" Thashë, "M'u ka mush menja që na shqiptartë e kem prejardhjen prej dreqit", "Tybestikfa, qysh po thu ashtu?" Thashë, "Po unë të thashë që nashta po gaboj", thashë, "se dreqi ka qenë melaqja e parë në xhenet", thashë, "po e ka bo ni gabim e Zoti e ka përzanë prej xhenetit. E i ka thanë, 'Dil nëpër dyje bon çka të dush'. Edhe neve na kanë lanë nëpër dyje edhe kurrë rehat s'po bohemi" (qeshë).

Se ky shoku i grupit, ni shok shumë i mirë, Mehmet Hajrizi thotë, "Nëse ta merr menja që për ni çashtje ki faj, studio pak ma mirë se ndoshta krejt faji është i yti". E më doket krejt faji ynë ka qenë gjithmonë që kemi mbetë gjithmonë në margjina të historisë, se nuk kemi reagu si duhet në shumë ngjarje. Edhe

pse neve dy herë na u ka cunue inteligjenca. Janë pre njerëzit ma të meçëm dy herë në kohën e Perandorisë Turke [Osmane], në Janinë edhe në Shkodër edhe kemi mbetë pa krye na. Pa kokë nuk qëndron trupi. E na kemi mbetë pa kokë, fatkeqësisht, por besoj që kanë me u kfishellë, kanë me ardhë në vend të vet.

Anita Susuri: Faleminderit shumë!

Sherafedin Berisha: Me nder qofsh!